

INTERVISTË ME IGBALLE REXHA JASHARI

Vendi: Prishtinë | Data: 9 maj, 2021
Kohëzgjatja: 125 minuta

Të pranishëm:

1. Igballe Rexha Jashari (E intervistuar)
2. Anita Susuri (Intervistuesja)
3. Besarta Breznica (Kamera)

Simbolet e komenteve në transkriptë të komunikimi jo-verbal:

() - komunikim emocional

{ } - i intervistuari shpjegon me gjeste

Simbole të tjera në transkriptë:

[] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin

Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.

Pjesa e Parë

Igballe Rexha Jashari: Unë jam Igballe Rexha Jashari, kryesisht gjithçka e imja lidhet me Prishtinën, po mendoj si fmi, e mandej aktiviteti vazhdon në të gjithë Kosovën. Por, si fmi, prindërit e mi, babai është nga fshati Rimanishtë komuna e Prishtinës dhe nëna nga fshati Barilevë, po ashtu komunë e Prishtinës, te dytë. Domethonë, babai është Ali Rexha, kurse nana Selime Shala është e familjes Shala të Barilevës. Jam fëmija i parë pas shtatë viteve martesë të prindërve.

Ata janë martu rreth moshës 18 vjeçare dhe unë jam fëmija i parë. Pastaj jemi shtatë fmijë, domethonë pesë motra dhe dy vllazër. M'u kujtu ktu që për t'gjithë fmitë, meqë ishim ndoshta edhe pas shtatë vitesh, kshtu fillun me fmi, baba im nanës nga ni lirë ia ka dhuru, dhuratë e ka pasë. Dhe po ashtu, a din, shpërblime tjera meqë ishim shtatë fmi. Ishim fillimisht vajzat, katër vajzat, mandej dy vllazën edhe ni motër, motra e vogël.

Muj me thanë që si familje kemi qëndru mesatarisht mirë. Kemi qenë mirë meqë babai ka punu, domethonë fillimisht në Kombinatin bujqësor industrial, që atëherë quhej PIK [Poljuprivredni Industrijski Kombinat] dhe më pastaj në KEK. Domethonë, ka qenë deri në grevën e 3 shtatorit ku osht' përjashtu prej punës. Ka punu në KEK. Unë si fmi i parë, si fmi nëpër Prishtinë, domethonë Prishtina natyrisht që është ndryshu shumë prej atyne viteve bashkë me mue që kam ba vite (qeshë).

M'kujtohet këtu domethonë si fmi që ende nuk i kisha shtatë vite, babai po m'thotë, "Dalim i marrim këto, blejmë diçka me ty", edhe ishte viti '68. Domethonë, po flasim për nëntorin, 27 nëntorin, faktikisht demonstratat e vitit '68. Edhe une në këto lokalet ktu, n'këtë rrugë që kanë qenë lokalet e vjetra te Trekandëshi [Monumenti i Revolucionit] aty, domethonë edhe poshtë shëtitëm me babain. M'i blejti ni palë kpuca edhe kur u bo mramja ai m'thotë, "Duhesh me shku n'shpi vet", a din, "po t'qes me ni taksi".

Taksit atëherë ishin qerre me kuaj, domethonë ata ishin taksi edhe pajtonat. Edhe m'qet me ni pajton domethonë aty edhe te komuna ku është tani aty ishte ai parkingu i taksive. Edhe tashti më duket që

po e shoh, domethonë filloi me u ngjitë me shku kah teatri shkallëve aty te Trekandëshi edhe shkollve me ni pallto t'gjatë. Kur shkoj n'shpi, nana thotë, "Ku mbeti ai?" Thashë, "Nuk erdhi".

Ajo e kish ditë që, domethonë janë organizimi i demonstratave edhe... se dajhtë ishin, dajën e kisha n'atë kohë n'burg. Domethonë, t'burgosun n'viti '64 së bashku me Adem Demaçin dhe ishte dënu 13 vite. Edhe daja tjetër po ashtu, domethonë e ditke që veç osht' pjesëmarrës i demonstratave. Edhe fillun aty në shpi, merakosja e axhallarëve, t'gjithë domethonë pse ai ka mbetë në demonstrata. Atë natë nuk u kthi babai im, domethonë kishte mbetë nga përndjekjet e policisë kishte mbetë në ni, diku në rreth të Prishtinës në ni luginë, domethonë, derisa janë tërheqë policia edhe mandej mas mëngjesit u kthi n'shpi.

Gjanat tjera si fmi, domethonë kemi qenë shumë shumë të lumtur faktikisht si fmi, si familjarë, si nxanës të mirë në shkollë, domethonë. Unë isha në mesin e pesë nxënësve n'klasë, n'shkollën fillore në "Zenel Hajdini" në Prishtinë, në mesin e pesë nxënësve t'shkëlqyrshëm. Po ashtu edhe gjashtë fmi tjerë kanë qenë të shkëlqyeshëm të gjithë në mësim. Kjo ishte ni lehtësim për prindërit natyrisht, që ne msonim. M'kujtohet biblioteka ish "Miladin Popović", domethonë që e kemi frekuentu shumë. Unë...

Anita Susuri: N'cilën lagje keni jetu ju?

Igballe Rexha Jashari: Në Kodrën e Trimave. Domethonë, kur kanë ardhë prindët ka qenë viti '59 kur i kanë ble tokat n'atë pjesë. Toka, shumë toka që i kanë shitë për troje mandej. Kanë ardhë axhallarë edhe aty edhe sot domethonë jetojnë familja ime faktikisht.

Anita Susuri: Si e kujtoni Prishtinën n'atë kohë? Sa keni qenë fmi ose...

Igballe Rexha Jashari: Me urat me drrasa, domethonë, me lumenj, vërshimet e lumenjëve nëpër lagje. M'kujtohet që kemi shku, arsimtarin e matematikës e kisha ktu te lumi dikund domethonë që e kishte marrë lumi edhe shkum me i ndihmu si nxanës që ta pastronte pak shtëpinë. Shkum për ni kërkesë tonën, domethonë po ajo e kishte marrë uji edhe shkum n'atë lagje. Prishtina me dyqanet e vogla, domethonë, këtë pjesë ktu edhe ombeltoret e mira shumë. Ombeltorja pikërisht te lumi që po thom te ura, te tregu aty që ka qenë edhe atëherë edhe po ashtu ombeltorja te "Fanoti" i thojshim, domethonë. S'e di sa domethonë, por "Fanoti" janë edhe tani e ishin ëmbëltores ato shumë t'mira që babi im ishte adhurues i atyre tumbullave edhe limondave.

Edhe ne, domethonë zakonisht si fmi n'ato ombeltore, n'ato... Si fmi mandej kom qenë n'grupin e artit të shkollës edhe n'grupin e artit të Prishtinës. Vizatimet nëpër rrugë, domethonë, që i bojshin si grup i artit të Prishtinës kanë qenë interesant. Edhe tani m'kujtohen. Aty teatri domethonë u mbushke sidomos kur kishte ndonji ngjarje që dilshim me vizatu gjithë atë pjesën para teatrit. Rruga që ishte e ngushtë atëherë, domethonë, edhe trotuaret, i mbushim me vizatimet të ndryshme si grup i artit të

Prishtinës. Kam shkru poezi n'atë kohë, domethonë poezi t'cilat janë publiku në gazetën e murit të shkollës.

Mandej kam shku në Gjimnaz, Gjimnazi ish "Ivo Lola Ribar", domethonë kom qenë nxanëse e gjimnazit atëherë, tani "Sami Frashëri". Si këto rrugë, domethonë, natyrisht që mbajnë shumë kujtime të të gjithë fminis. Kjo pjesa tani e qendrës që është domethonë aty rreth gjimnazit edhe kjo pjesa deri te, edhe deri te "Tri Kapelat" po ishte shumë pak domethonë lëvizje. Ato dyqanet e mira, veshmbathja ka qenë shumë e mirë domethonë, se ishte tekstili në atë kohë tjetër edhe po ashtu mbathjet jo shumë dyqane, pak dyqane kanë qenë. Po ato dyqane që kanë qenë ishin me materiale të mira.

Anita Susuri: E di që, tash ju jeni pak ma e re, ma herët qysh kemi ndëgju, qendra ka qenë deri kur është Grand Hoteli edhe mandej ka qenë periferi...

Igballe Rexha Jashari: Periferi ka qenë.

Anita Susuri: A ju kujtohet kjo?

Igballe Rexha Jashari: Po m'kujtohet, po. M'kujtohet, jo shumë, se po thom deri te "Tri Kapelat" pak ma tutje, domethonë. M'kujtohet domethonë që deri aty. Edhe ajo pjesa kur osht' ba me dyqane aty te Grandi domethonë edhe ashtu domethonë kur kanë fillu qato ndërtimet n'atë pjesë, m'kujtohen si fmi. Mandej ka qenë dyqani i madh që ka qenë ktu "Uzor" i thojshim atëherë, domethonë ka qenë pikërisht n'këtë pjesën ktu n'kand ku është tani kuvendi, ndërtesa e kuvendit, po këto dyqanet e vogla. Një dyqan shumë i madh me gjana të imta.

Kaloi kjo. Kur u ndërtu, kur filloi qai ndërtimi që po thom, edhe n'atë pjesë kaloi te Fakulteti Ekonomik n'atë pjesën ku osht' lokali n'anën tjetër t'rrugës, Ministria e Arsimit dhe përballë ai kandi. Ai dyqan, domethonë, kur filloi ai ndërtimi i Prishtinës në atë pjesë, fillun zgjerimin n'atë pjesë filloi. Në shkollë, faktikisht në shkollë meqë edhe gjimnazi ka qenë shkollë ma e mirë që ka kërku angazhimin, domethonë. Unë deri në vitin e katërt, në vitin e katërt gjysëm vjetorin e dytë faktikisht jam marrë me aktivitete.

Përndryshe, domethonë gjatë kohës të gjimnazit, jo, nuk jom marrë me diçka personalisht, domethonë unë, kryesisht me mësim domethonë unë edhe me shoqërimin, me ato knaqësitë e shkollës. Kemi qenë ni klasë shumë shumë e mirë, shumë. Pas luftës e festum 25 vjetorin, natyrisht po takohemi herë pas herë sepse ni numër i madh i tyre edhe është nëpër Prishtinë. Kanë qenë, domethonë kryesisht të Prishtinës po kanë, edhe ka që kanë migru jashtë, domethonë edhe prej klasës të kohës të gjimnazit.

Anita Susuri: Me çka jeni marrë ju atëherë si rini?

Igballe Rexha Jashari: Si rini, si rini vetëm kemi dalë, domethonë se nuk jemi marrë me diçka të veçantë po kemi dalë. Ka qenë korzoja domethonë që janë dalë shumë shumë shumë. Unë s’jom dalë shumë në korzo si fmi, domethonë atëherë. Kom dalë shumë pak n’atë kohë. Jam marrë kryesisht me lexime, domethonë edhe me bibliotekën edhe në kohën e lirë kom adhuru sporte të ndryshme që kam përcjellë. Kom qenë adhuruese, që tash m’imitojnë vllazër e motra, domethonë që kur kishte ndeshje futbollit, basketbollit, domethonë unë leja gjithçka edhe, domethonë ato i përcjellja. Vet kam qenë kureshtare për ato, jo që kam qenë pjesëmarrëse. Po kom qenë adhuruese, domethonë e sporteve të ndryshme edhe aktiviteteve të tjera.

Po shkolla si shkollë nuk ka pasë domethonë diçka aktivitete që është bërë gjatë asaj kohe. E di që domethonë, në gjuhë shqipe mbajshim shënimet t’veçanta për secilin mësim edhe profesori i gjuhës shqipe e merrte fletoren, kom qenë ashtu me bukurshkrim edhe me ato detajet, domethonë, edhe nëpër klasë tjera që e tregonte si shembull të mirë. Ndërsa që thashë në vitin e katërt erdhën disa aktorë që me kërkun nëse ka t’interesum për aktrim prej nxënësve të gjimnazit, sidomos viteve të katërta.

Dhe unë thashë po e provoj ni intervistë, domethonë të, te Asllan Hasaj regjisor i teatrit domethonë, n’atë kohë edhe Skender Nimani, që na merrnin në intervistë [neve nga] ata që shkum. Dhe ata, ajo intervista aty dhe ai leximi shumë shumë bukur. Kështu që, domethonë, unë, thashë, okej po pranoj që të vazhdoj me lujtë ndonji rol. Fillimisht e kisha rolin e nënës në librin e Maksim Gorkut. Domethonë, ishte ni rol shumë interesant, shumë. Tash m’del përpara vetja, domethonë, plakë me thinja, domethonë, aty në atë rol. Dhe po ashtu lujta rolin e Hajrisë në “Halili e Hajria” i Kolë Jakovës libri, domethonë këto ishin dy dramat.

Me qëllim domethonë ashtu thuhej, me qëllim që kto trupat artistike shkonin në Shqipëri gjatë asaj kohe, viti ‘79-‘80, deri në demonstratat e ‘81-tës dhe kush ishte n’këto kishte mundësi, domethonë edhe kjo ishte një arsye që unë, domethonë, shkova në, me lujtë n’ato drama.

Anita Susuri: A keni shku ju në Shqipëri?

Igballe Rexha Jashari: Jo, se domethonë kur e kemi shfaqë premierën “Halili e Hajria” ishte ndoshta shkurti i vitit ‘81 dhe domethonë ishin demonstratat. Kështu që, gjithçka edhe n’atë drejtim nuk u realizu.

Anita Susuri: E çfarë... çka organizonit ju për Shqipëri? Qysh e paramendonit?

Igballe Rexha Jashari: Nuk kishim domethonë, ne kishim vetëm atë idealizmin për Shqipërinë që Shqipëria, që jam shqiptar, domethonë që tokat shqiptare. Nuk kishim ndonjë diçka që atje është bukur. Të gjitha trupat artistike që kanë ardhë gjatë asaj kohe kom shku edhe i kom përcjellë koncertet në sallën 1 Tetori, në Sallën e Kuqe, në Pallatin e Rinisë që ishin në vitin ‘79 domethonë edhe në të

gjitha kom hy. Kom gjetë forma edhe kom hy n'ato koncertet. Po ashtu grupet që vishin të sporteve basketbollistët, m'kujtohet domethonë që takimi, e kisha vllaun që thashë mas katër motrave e vllau quhet Shqiptar, edhe e mora domethonë atë për dore edhe shkum, në Grand ku ata rrishin edhe thashë, “Po dëshiroj me ju njoftu ktu me ni shqiptar”, edhe ata si basketbollistë që ishin e merrnin nëpër duar secili, domethonë, që *auuu* {onomatope}, edhe kto, emrin.

Tash m'u kujtu, domethonë që emrin faktikisht daja që, siç thashë, ishte i burgosun edhe në vitin '70 është liru. Me ramjen e sistemit të Rankoviçit¹ n'atë kohë, iu kanë falë vitet tjera. Dhe ai kur kishte dëgju që nana osht' shtatëzanë, atëherë kishte thanë, i kishte thanë dajës që nëse lindë, domethonë, kish qenë mirë emrin Shqiptar. Nana vetëm këtë vlla e lindi në shtëpi jo në spital, domethonë e thirri atë ndihmësen që atëherë quhej mami. E thirri atë ndihmësen që ajo t'vjen në shtëpi edhe t'lind n'shtëpi dhe ajo, a din, ashtu... edhe ky, ni detaj shumë interesant, hapi dritaret, “Ka lind ni Skënderbeg”, domethonë këtu edhe e pagëzum.

Unë thashë, babi im tha, “Ti si dëshiron ashtu ia len emrin” thashë, “meqë kom ndëgju se edhe unë isha shumë e vogël domethonë i kisha nantë vite. Thashë, “Nëse m'dëgjon meqë ka thanë daja duhet Shqiptar”, tha, “Okej”. Po për këtë emër kom vujtë une shumë. Sepse, po kaloj prej ni momenti n'tjetrit, por po e lidhi me këtë. Në vitin '89 kur vllau im shkoi ushtar, domethonë edhe fillun t'vijnë kufomat prej gjithë Jugosllavisë t'ushtarëve për mu ishte, domethonë ni vujtje e vërtetë, domethonë kjo që pse e kemi pagëzu me këtë emër që çdo mëngjes që ata e thrasin Shqiptar do iu mërzhitet.

Nuk vonoi ni muj, domethonë edhe na thirrën thanë që është sëmure. Ishte në Titograd atëherë domethonë tani Podgoricë. Edhe kemi shku me babain tim, me bashkëshortin, domethonë, n'atë kohë edhe shkum për ta pa. Po ishte smu sepse ishte ni fmi i ndjeshëm natyrisht edhe kur e kanë fut në Lumin Moraça, si ushtarë që i kanë fut. Ai meniherë ka marrë atë ftohjen edhe... mandej kaloi ajo, po e mbaroi ushtrinë domethonë.

Anita Susuri: A ka pasë probleme gjatë ushtrisë?

Igballe Rexha Jashari: Pak. Faktikisht ai komandanti që ishte ishte kroat dhe babai im u lidh me të i tha që, “Për çdo herë që ti merakosesh veç më thirr n'telefon”, domethonë, “edhe je i lirë domethonë me u interesu për të”. Kemi shku disa herë faktikisht, domethonë edhe ta vizitojmë edhe... po ai e përfundoi domethonë ushtrinë megjithatë. Po edhe gjatë viteve '90, ai asnjherë leternjoftim me veti nuk e ka bartë, domethonë. Sepse ishte shumë i rrezikun faktikisht, domethonë, për shkak t'emrit.

¹ Aleksandar Ranković (1909-1983) ishte hero partizan serb i cili mori pozitën e Ministrit të Punëve të Brendshme në Jugosllavi dhe ishte udhëheqës i Inteligjencës Ushtarake pas Luftës së Dytë Botërore. Ai krijoi një sistem terrori në Kosovë, pasi që e konsideronte atë si rrezik për sigurinë e Jugosllavisë nga 1945-1966, kur dhe ai u largua nga Lidhja Komuniste.

Anita Susuri: Deshta me u kthi pak te shkollimi, thatë që keni pasë qef shumë me lexu...

Igballe Rexha Jashari: Po.

Anita Susuri: Edhe kanë qenë disa libra t'ndalume n'atë kohë. A ju kanë ra juve nëpër dorë? A i keni lexu? Edhe qysh i keni marrë apo?

Igballe Rexha Jashari: Po, meqë thashë që dajën e kisha edhe dajtë faktikisht ishin, ai, në atë pjesë që libra kishin mjaft. Daja ish profesor i gjuhës shqipe që e kishte kry në Beograd, domethonë fakultetin dhe ishte profesor i gjuhës i Shkollës Normale në Prishtinë kur u burgos. Ishte profesori i parë faktikisht që ka shkru në ditar në gjuhën shqipe. Ishte profesori i parë që e hoqi mbishkrimin në gjuhën serbe në shkollë, domethonë n'atë kohë kur punoi. Këtu dikund, këto banesat që kanë qenë t'vjetra, ai ka jetu n'këtë pjesë. Edhe po ashtu, daja tjetër ishte profesor i gjuhës angleze. Po domethonë dajtë ishin me kto libra, me këtë literaturë vazhdimisht dhe ne e kemi pasë ma t'lehtë edhe furnizimin me këtë pjesë të literaturës domethonë, të... përveç librave që ishin në biblioteka.

Në vitin '81 u burgos djali i dajës, djali i këtij dajës domethonë, edhe ai ishte jurist i posadiplomuar edhe i punësuar edhe u burgos edhe u dënu me dhjetë vite burg. Kështu domethonë ishte ni pjesë që ne e kishim qasjen vazhdimisht në këtë, aksesin faktikisht në këto libra edhe në këtë literaturë që të lexojmë. Dëgjoni Radio Tiranën vazhdimisht. Nana ime domethonë e ka, përherë e ka lshu Radio Tiranën n'atë kohë. E kishte ni radio që ia solli daja tjetër, ni radio, ato radiot e para t'mdhajat që ishin. Radiot e para në Kosovë faktikisht. Dhe ajo përherë domethonë edhe Radio Tiranën ishte ni pjesë që ne, domethonë e kishim këtë pjesën e frymëzimit, e idealeve, e punës, e brumosjes ndoshta, kështu.

Anita Susuri: Në vitin '74 është, domethonë ka [ndryshu] edhe kushtetuta...

Igballe Rexha Jashari: Kushtetuta, po.

Anita Susuri: Edhe ka qenë ni periudhë pak ma e ndritshme me thonë për shqiptartë edhe e Kosovës, a ju kujtohet juve? A keni pa këtë dallim?

Igballe Rexha Jashari: Po unë mund t'them tash këtu vërtetë njerëzit e shohin në aspekte t'ndryshme se pak ka qenë ajo pjesa që e ka pa n'atë kohë e ka pa edhe atë shtypjen, domethonë. Sepse nifare lirim ndoshta ishte, universiteti, ishin disa gjëra. Por, krahasuar me popujt tjerë ishim të shtypur vazhdimisht. Ishte mirëqenia. Unë thashë që edhe baba im është punësu në KEK që prej vitit '70 edhe kanë qenë pagat e mira, shumë t'mira faktikisht, domethonë. Por, ishte shtypja, ishte n'forma të ndryshme ishte shtypja. Ishte që ti nuk ishe i barabartë me popujt tjerë të ish Jugosllavisë edhe sado që ishte ni ofrim i lirisë në kuptimin e arsimimit, domethonë n'atë kohë. Filloi arsimimi, fillun ato, po megjithatë ishte ende larg vendeve tjera të ish Jugosllavisë.

Anita Susuri: Domethonë, gjatë shkollës të mesme m'tregutë për shoqinë edhe për daljet e juja. Çka tjetër ju mbetet si kujtim prej qytetit të Prishtinës t'asaj kohe?

Igballe Rexha Jashari: Prej qytetit, zejtartë domethonë, ata farkatarët, sidomos farkatarët m'u kujtu tani që kalonim, ishim me babin përdore edhe motra ime ishte shumë kureshtare, që tani është e ndjerë, domethonë, ka dy vite e gjysë që s'jeton (qan).

Anita Susuri: A keni vazhdu me fakultet? Pse e keni zgjedhë këtë drejtim? Si ka ardhë deri te ajo? Plus është ni vit kur kanë fillu demonstratat? E krejt qito që mundeni me na tregu.

Igballe Rexha Jashari: E kam përzgjedhë fakultetin ekonomik sepse une isha, përveç kësaj pjesës që thashë që isha të kulturës, gjuhës që e kishim pak edhe si gjenetike. Une e kom dashtë matematikën, e kom njoftë matematikën, kom qenë adhuruese edhe gjimnazi natyrisht që ta jipte atë mundësi të njohjes ma tepër t'matematikës. Nuk kisha dëshirë që, domethonë t'jem mjekësi ose dikund. Domethonë, ato fakultetet po ishim në ekonomik edhe ishim një numër i madh i shokve edhe shoqeve t'klasës faktikisht kemi shku në ekonomik. Dhjetë apo dymbëdhjetë, domethonë prej klasës tonë ishim që kishim shku në fakultetin ekonomik. Edhe kjo ishte pikënisja që une t'vazhdoj me fakultetin ekonomik.

Në vitin '81 aty ku domethonë, para pak kohë para demonstratave ishte ni grup i studentëve faktikisht që ishin, punonin në grupe të ndryshme, unë nuk isha e organizime në ndonji grup, domethonë e kisha vetëm prej vetës atë pjesën. Po edhe ato më ftun në konvikt të studentëve, domethonë që për mu ishte interesant. E para herë dhe e fundit domethonë që kam shku në konvikt faktikisht me ato shoqet atëherë. Edhe m'tregun domethonë që janë duke punu diçka në këtë drejtim.

Edhe unë meqë dëgjova ashtu e kontaktova edhe djalin e dajës që thashë është burgosë edhe i them kështu, kështu. Domethonë, "Do t'ketë diçka në Kosovë gjatë kësaj kohe". Thotë, "Do t'ketë, por jo tani". Domethonë, "Do të ketë". Por, ai m'thotë, "Jo tani. Është ka punohet". Ai s'thoshte normalisht që vet. Por, "Është kah punohet. Janë grupe të ndryshme që janë duke punu n'atë drejtim edhe, sepse jemi keq me disa gjëra" edhe shpjegimet e tina që ishte edhe ma i madh se unë natyrisht.

M'kujtohet edhe n'amfiteatër isha kur kanë ardhë edhe kanë thanë që domethonë në menzën e studentëve është, ka fillu ajo, ka shpërthyer. Në amfiteatër erdhi ni person që tani s'më kujtohet cili ka qenë, domethonë disa thojnë Ali Lajçi, por mu s'mu kujtohet personi. Por, e di që është hapë dera amfiteatrit dhe domethonë kanë thonë që, "Dilni edhe ju edhe çonu edhe ashtu..." edhe mandej pjesëmarrja në datat e mbajtjes të demonstratave ka qenë edhe unë, motra ime ishte nxënëse e vitit t'parë të shkollës "Sami Frashëri" tani, domethonë, po ashtu edhe gjimnazit "Ivo Lola Ribar".

Dhe, domethonë, unë kur fillun demonstratat e 1 prillit [1981], faktikisht isha në shtëpi se nuk e dita, meqë nuk isha n'ato grupet, nuk isha... por, meqë dëgjova që u shpërthy atje, atëherë domethonë u nisa menihere edhe pas meje erdhi motra ime që ishte vetëm 15 vjeçare n'atë kohë. Sigurisht, unë përpiqesha, domethonë ajo t'kthehet n'shtëpi po ktu te kuvendi ku osht' domethonë aty i kemi pa që janë protestustë duke ardhë, demostrustë faktikisht, domethonë, dhe ne jemi bashkangjitë aty.

E largova edhe niherë deri te tregu motrën time e përcolla që ajo t'kthehet n'shtëpi, por ajo përsëri m'u kish bashkangjitë atë ditë. Domethonë, edhe kemi qëndru aty, pikërisht para megafonit, domethonë para atyne fjalëve që domethonë u thanë, kemi dëgju derisa domethonë intervenun policia. Kemi hi në njëren prej ndërtesave që atëherë ishte "Krashi"², te ÇIK-u tani ku osht', s'osht' as ÇIK-u tani (qeshë). Dyqani, lulet ku janë, lulet ku janë t'vendosuna n'atë pjesën përballë Ministrisë së Kulturës që janë edhe janë aty lulet, ishte dyqan, ÇIK, nëse dikujt domethonë, na orientimin e kishim ashtu.

Kemi hy në atë hyrje, domethonë, të ndërtesës së bashku me motrën kemi hy disa njerëz. N'fillim veç na mbyllën, domethonë që t'mos dalim edhe hudhën gazin lotsjellës edhe t'mos dalim nga aty po meqë ishin britmat shumë t'mdhaja edhe njerëzit siç duket, domethonë thanë, "Dilni" po dikë e kapshin prej atyne aty. Edhe ne kemi ikë rrugës te poshtë, me, gazi lotsjellës motrën time, domethonë, edhe ma shumë e mundoi natyrisht që, edhe e thashë që ishte barrë n'këtë rast, domethonë, për mu se u dashtë, domethonë, me majtë edhe mos me e lëshu, ku i kemi pa policinë.

Mas disa orëve edhe kemi mbërri n'shtëpi, domethonë atë natë. Po, motra ime ka vazhdu me organizimin e nxanësve t'nesërmen, domethonë ajo që 15 vjeçare ashtu ka qenë vet. Nga përndjekja e policisë i kanë dërgu dikund përmbi Shkollës Normale mbi Gërmi n'atë pjesë. Edhe ajo me flamur n'dorë ashtu domethonë ishte rrokullisë edhe nuk u kthy domethonë ni natë, faktikisht ka mbetë atje.

Edhe rrezikimi për përjashtim nga shkolla ka qenë për të. Ishte profesori Ali Ahmeti, i ndjerë, që ka qenë profesor shumë shumë i mirë i gjuhës shqipe. Kujdestar i klasës që e ka shpëtua faktikisht mos me përjashtu se ishte nxansja ma e mirë n'shollë. Ishte kryetarja klasës, domethonë, kishte t'gjitha pesa edhe mos m'u përjashtu prej shkolle. S'e di si e ka arsyetu, por, domethonë e ka shpëtua pa u përjashtu nga shkolla.

Anita Susuri: N'familje të juv kur keni shku, a janë shqetësu prindërit? A qysh ka qenë...

Igballe Rexha Jashari: Shumë, shumë, domethonë, nana ka dalë mas neve njihere, domethonë, që, "Mos, mos, mos shkoni", po është kthy. Po, janë shqetësu shumë. Baba nuk e ka ditë se ishte domethonë n'punë, po nana po shumë. Edhe, "Mosni, mosni, mosni, se nuk duhet", shqetësimi si i prindërve normalisht që ka qenë shumë i madh se ishim faktikisht t'reja. Edhe unë isha e re po motra sidomos ishte shumë ma e re se unë, ishte pesë vjet ma e vogël. Normal që ishte e re shumë.

² Kraš, dyqan i bombonave me bazë në Kroaci, por i pranishëm në të gjitha republikat dhe krahinat e Jugosllavisë. Në Prishtinë ky dyqan ndodhej pranë sheshit të sotëm Nëna Terezë.

Anita Susuri: Çka keni pa tjetër ato ditë? A ka pasë dhunë?

Igballe Rexha Jashari: Po, si jo, dhunë ka pasë, absolutisht dhunë. Edhe na do pendreka, domethonë, ashtu, po natyrisht, domethonë, ishte dhunë ishte gjithçka. Prishtina e nxirë nga gjithçka domethonë, natyrisht. Ajo ishte ni pikënisje domethonë e viteve, faktikisht '81. Ishte ni qetësi pak a shumë deri n'vitin '88-'89 po ajo ishte faktikisht ni nismë e t'gjithë zhvillimeve të matutjetshme.

Anita Susuri: Si e keni vrejtë ju pastaj këtë... mas demonstratave ka fillu edhe diferencimi, ka fillu edhe burgosja...

Igballe Rexha Jashari: Absolutisht.

Anita Susuri: Çka dini ju rreth krejt kësaj?

Igballe Rexha Jashari: M'kujtohet domethonë vetëm që nuk ishin edhe shoktë në fakultet. Disa mungonin, fillun t'mungonin domethonë ashtu që burgosja e tyre. E kuptova që janë grupe, domethonë disa prej aty, të shokve të fakultetit. Natyrisht që m'u burgos djali i dajës, domethonë në atë kohë edhe u dënu me dhetë vite. Kishte burgosje të shumë grupeve, ishin edhe të shoqnisë, faktikisht edhe të shoqërisë time, motrave, vllazërve që, domethonë që kishin të burgosur.

Ishte ni situatë e randë për ata që ishin n'atë fat domethonë, se s'ishin për t'gjithë domethonë. Po, masivizim ishte, i gjithë situatës. Krahasuar me kohën kur osht' burgos daja n'vitin '64 ishte ni masivizim i masës, domethonë tjetër në vitin '81, për shembull. Ishte tjetër. Unë për vete, po them, domethonë që nuk kom hezitu të flas për ni të drejtë, s'kom hezitu asniherë, as n'mesin e shokëve, shoqeve. Domethonë, ishin forma të ndryshme që e kuptojshë kush ku osht'.

M'kujtohet ni koleg i Strugës ishte në fakultet edhe kur e kuptoi pak a shumë që ishim disa veta, s'isha domethonë vetëm unë edhe ashtu, domethonë vazhdimisht, "Vendin e keni t'rujtun këtu n'amfiteatër", "Ku na dokët balta ma e omël se mjalta". Domethonë edhe ishin disa shprehje që... n'atë kohë kom lujtë edhe n'disa skeqe n'kuadër të shoqërisë "Drita" të Fakultetit Juridik. Kom marrë pjesë, domethonë, ni herë.

Ehat Musa ishte domethonë këngëtari që vinte nga Struga edhe në sallën e gjelbërt në Pallatin e Rinisë kom lujtë n'disa skeqe që vazhdova pak a shumë me atë fahun edhe ai grupimi i njerëzve n'forma t'ndryshme ishte Naser Gjinovci domethonë edhe ishte Aqif Mulliqi që e bante atë shoqni edhe ishte edhe kjo ni pjesë, domethonë e kënaqshme edhe ni kohë që mora pjesë gjatë studimeve.

Anita Susuri: A kanë qenë si grupe amatore ato?

Igballe Rexha Jashari: Grupe amatore n'kuadër të fakultetit, n'kuadër të fakultetit, po.

Anita Susuri: Desha me ju pyte, a keni pasë ju profesorë nga Shqipëria?

Igballe Rexha Jashari: Jo.

Anita Susuri: S'keni pasë.

Igballe Rexha Jashari: Kemi pasë profesorë t'cilët kanë qenë Sami Peja në *Goli Otok*³ dhe po ashtu Hajrullah Gorani⁴. Profesorat t'cilët domethonë kanë vujtë në burgje dhe ne si student sidomos Hajrullah Gorani në pauzat e ligjeratave na ka mbajtë në takime ni grup studentësh që na fliste edhe për ato vujtje, por edhe për shqiptarët në përgjithësi, edhe profesor Sami Peja, tanimë të ndjerë. Domethonë që na flisnin për atë pjesë edhe për qysh duhet me qenë, domethonë shqiptartë që duhet me pasë ma mirë, qysh duhet me msu, m'u avansu. Si shqiptar ishte në atë kohë...

Anita Susuri: A e keni njoftë ju profesorët e Shqipërisë që i kanë largu? Nuk i kanë leju ma me ardhë me ligjërë.

Igballe Rexha Jashari: Fakulteti Ekonomik nuk mendoj që ka pasë ma tepër, domethonë në gjuhë shqipe edhe në mjekësi edhe në Fakultetin e Mjekësisë ka pasë profesorë prej atje, në Fakultetin Ekonomik nuk m'kujtohet dikush që ka qenë, jo.

Anita Susuri: Gjatë studimit ju m'tregutë që jeni marrë me aktivitete kulturore, a ka vazhdu, sa ka vazhdu kjo?

Igballe Rexha Jashari: Pak, domethonë, ni si me thonë ni semester ndoshta, gjatë asaj kohe, ni semester ishte.

Anita Susuri: E pse nuk e keni vazhdu?

Igballe Rexha Jashari: S'e di, ndoshta shoqëria, pushimi i verës edhe s'ju kom bashkangjitë vitin tjetër, ashtu. Domethonë, ajo ishte, ishin... ndoshta u rrita pak edhe (qeshë). Prindërit faktikisht nuk kanë dashtë që unë t'jem, domethonë në teatër edhe pse u pranova. Domethonë, m'pranun në Teatrin Kombëtar edhe kisha me nënshkru kontratën si me thanë, domethonë pas ni jave ma lanë mundësinë [me nënshkru]. Por, nana ime domethonë tha, "Mos e pyt fare babën se nuk është dëshirë e jona kjo", dhe unë domethonë hoqa dorë përfundimisht prej asaj pjese (qeshë).

³ Goli Otok është një ishull i pabanuar i cili ishte edhe lokacioni i një burgu politik gjatë kohës së Jugosllavisë. Burgu ishte në funksion midis viteve 1949 dhe 1989.

⁴ Hajrullah Gorani (1931- 2020) profesor, sindikalist shqiptar dhe ish i burgosur politik nga Peja. Ai ka qenë kryetar i Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Kosovës, ai mbahet mend edhe si udhëheqës i grevës së madhe të punëtorëve kosovarë, që u mbajt më 3 shtator 1990.

Anita Susuri: Kur keni fillu për herë t'parë me punu pasi e keni përfundu fakultetin?

Igballe Rexha Jashari: Kom fillu në vitin '87 në "Rilindje". Faktikisht isha pa e përfundu edhe ni provim a dy. Isha në Bibliotekën Kombëtare duke mësua së bashku me motrën time që thashë është [Shukrije Rexha](#) që ka qenë në Fakultet të Mjekësisë, tani në atë kohë dhe mësonim bashkë. Ajo përgatiste provimet dhe ajo vetë ka qenë ni, domethonë përherë me iniciativa me ide të ndryshme, vet ka qenë ashtu.

E kish pa konkursin në "Rilindje". Ajo e kishte pa. Edhe m'thotë, "Duhesh me shku në qit konkurs me marrë pjesë", unë mbajsha ditar, domethonë kom mbajtë ditar edhe kom shkru vazhdimisht, kom vazhdu me shkru, kom vazhdu me vizatu edhe vizatimet e tjera të familjarëve, kom vazhdu me atë pjesë. Edhe ajo duke njohur atë pjesën time që domethonë... thotë, "Duhesh me shku n'intervistë në 'Rilindje'", thashë, "Jo, nuk shkoj, në 'Rilindje'". Gazetari me ekonomik ishte diçka, "Ti e ki fat tandin. Pavarësisht që po insiston nga ekonomia e ki fat tandin. Duhesh me shku n'intervistë".

Atë ditë ishte intervista në ora 12:00, domethonë edhe unë prej bibliotekës në ora 11:00 jam çu jam shku në intervistë në "Rilindje". Kur kom hy ishte ni grup i madh i njerëzve që, domethonë kishin shku për intervistim. Faktikisht ishte intervistë me shkrim. Ishim njiqind pjesëmarrës në atë, 120 faktikisht. Domethonë, edhe hyna n'intervistë, ishin pyetje t'lamive të ndryshme duke fillu nga federata atëherë, kuvendet, organizimet, sporti, muzika, fusha të ndryshme, t'cilat pak a shumë i njifsha ashtu. Edhe thanë që rezultati i intervistës me shkrim është pas katër pesë dite.

Aty m'thonë, "Cilin e ke? Cili është personi që ka me t'pru edhe me t'përkrahë", se sikur tani domethonë edhe atëherë ishte. Nuk ka shansë me hy në "Rilindje" dikush që nuk ka njerëz edhe dikush që nuk e përkrahë. Thashë, "Jo, une kom ardhë kështu vet pa, as nuk e din dikush përveç motra ime", "Jo, s'ki shansë". Pas pesë ditëve që kishte me dalë shpallja edhe nuk shkova atë ditë. Hiç s'besova me të thanë të drejtën, shkova t'nesërmen. Edhe e pashë domethonë listën që ishin pranë 20 veta, në listën e tyre edhe unë.

Fillun se, fillun në kronikën e Prishtinës, ishte faqja për kronikën e Prishtinës në atë kohë në "Rilindje". Redaktori Esat Dujaka që deri tash ishte në 21-sh, në Televizionin 21 t'u punu edhe redaktori Shefqet Rexhepi te dytë ata. Fillimisht me kronikën e Prishtinës meqë isha edhe ata me ekonomi fillova me përcjelljen e ndërmarrjeve gjatë atyre viteve '87-'88 derisa filloi pjesa tjetër, periudha tjetër kohore. Ma vonë fillova edhe t'i përcjellë ndërmarrjet t'cilat ishin në Prishtinë, sidomos, domethonë ndërmarrjet prodhuese, shërbyese, tregtare e ato. Edhe derisa domethonë filloi ajo '89-ta, '90-ta vitet që ishte kohë e shkurtë, faktikisht nuk ishte shumë.

Pjesa e Dytë

Anita Susuri: M'tregutë që keni qenë në zgafellë gjatë periudhës së minatorëve...

Igballe Rexha Jashari: Në zgafellë jo. Kur kanë ardhë domethonë ktu.

Anita Susuri: Aha.

Igballe Rexha Jashari: Jo, domethonë kur kanë ardhë minatortë këtu.

Anita Susuri: Gjatë marshit.

Igballe Rexha Jashari: Po, po. Kur kanë ardhë këtu.

Anita Susuri: A e kujtoni atë ditë? Si ka qenë?

Igballe Rexha Jashari: Atë ditë domethonë jam... muj me thanë secilën ngjarje edhe janë emocione shumë t'mdhaja kur e kujton. Kur e kujton gjithë ato se, faktikisht këtu dukej një zgjuarje. Për mua dukej ashtu, ndoshta jo për njerëzit tjerë. Po për mua domethonë ishte një zgjuarje, pavarësisht pasojave. Ishte një zgjuarje për atë se domethonë ne e kishim ende që e përjetonim që nuk ishim t'kënaqun me të drejtat tona. Ishte një zgjuarje, ishte dhimbje për ata që, domethonë humbnin jetë që... po ishte një zgjuarje në përgjithësi e njerëzve.

Ishte edhe gëzim edhe ishin të gërshetuara domethonë dy antë në atë kohë kur i shihshe edhe minatorët. Ishte... për minatorët secili ka ndje ni dhimbje t'veçantë domethonë se ata ishin njerëzit që faktikisht e mbanin ni ish Jugosllavi në atë kohë. "Trepça", e puna e tyre ishte shumë e vështirë, shumë e randë e kur vjen koha që edhe ai të ngritet prej zgafellës edhe ai të del t'i kërkon të drejtat, ishte për neve... kur ata janë pse jo të tjerët domethonë, pse jo të tjerët të dalin dhe t'kërkojnë të drejtat e tyre?

Anita Susuri: E a ju kujtohet konkretisht, për shembull çka keni pa ju? Ata kanë hy në sallën e Boro dhe Ramizit...

Igballe Rexha Jashari: 1 Tetori, jo në Boro Ramiz. Në 1 Tetori domethonë, aty janë vendosë, aty kom ndejtë edhe une me ato batanijet kom ndejtë ni natë. E di që e kam ba, por kom shku herë pas here në atë pjesë se ishte mbushur plot salla domethonë. Unë edhe si gazetarë natyrisht, se isha në atë kohë gazetarë, po edhe si pjesëmarrëse, si... faktikisht edhe si shoqëruese e atyre që ishin aty. Ishte numër i madh, s'kishe ku ulesh n'atë kohë. Domethonë, aty kishte njerëz të shtrirë që e bonin kohën aty, që bukë sillnin t'gjithë ushqime të ndryshme atyre njerëzve.

Anita Susuri: E minatortë kanë qëndru aty ni natë a?

Igballe Rexha Jashari: Po. Kanë qëndru aty.

Anita Susuri: Tjetër, kush ka qenë?

Igballe Rexha Jashari: Kanë qëndru edhe të tjerët, po, po. Ishte plot salla aty, domethonë, plot salla. U mbajshin fjalime domethonë edhe pritej që ndoni intervenim prej policisë, ashtu, po ato marrëveshjet derisa u arritën mes tyre domethonë.

Anita Susuri: A ka pasë, për shembull, që kanë ardhë politikanë të asaj kohe me folë?

Igballe Rexha Jashari: Ka ardhë dikush, po s'më kujtohet emri, s'më kujtohet kush faktikisht.

Anita Susuri: [Kaqusha Jashari](#), ka qenë [Azem Vllasi](#)...

Igballe Rexha Jashari: Atje nuk m'kujtohen. M'kujtohet vetëm n'këtë pjesën, domethonë në qendër të qytetit. Nuk m'kujtohet n'atë pjesë kush ka ardhë.

Anita Susuri: E në qendër të qytetit që po thoni, a ka qenë?

Igballe Rexha Jashari: Në qendër të qytetit kur veç u ngritëm, domethonë edhe n'qendër të qytetit ishte ni fjalim atëherë që u mbajt prej disa njerëzve edhe protestues domethonë, qajo që ato thirrjet, "Trepça është e jona", "Kosova Republikë", e ashtu. Aty e di që ka dalë domethonë edhe Azem Vllasi edhe Kaqusha, kanë dalë me folë para protestuesve që, domethonë "Duhet të qetësoheni, duhet të shkoni nëpër shpija, bohet ma keq". E kështu.

Anita Susuri: Kjo ka qenë n'qendër...

Igballe Rexha Jashari: Në qendër të qytetit. Ishte Komiteti, tash, po mendoj ku osht' Ministria e Kulturës ishte ish Komiteti pikërisht aty, domethonë...

Anita Susuri: A ka qenë n'atë kohë kërkesa e atyne "Kosova Republikë", apo...

Igballe Rexha Jashari: Ka qenë...

Anita Susuri: Apo veç mbrojtja e ktyne...

Igballe Rexha Jashari: Jo, ka qenë "Kosova Republikë", ka qenë, kanë qenë kërkesat edhe n'atë kohë, po.

Anita Susuri: Si është pritë kjo kërkesë? Ka qenë pak e rrezikshme.

Igballe Rexha Jashari: Po '89-ta mandej duke pasë parasysh '81-tën, nuk kishte ma domethonë që s'ishte ma se ishte ni kërkesë e përhershme e tjerëve. Ka qenë e rrezikshme, por thirrjet kanë qenë domethonë për "Kosova Republikë", kanë qenë absolutisht.

Anita Susuri: Aty intervenim a ka pasë të policisë?

Igballe Rexha Jashari: Jo nuk ka pasë sepse me fjalimin e tyre atëherë është shpërnda masa.

Anita Susuri: Tjetër çka ju kujtohet prej asaj ditës, për shembull si është shpërnda masa? Ata e di që kanë ardhë n'kamë.

Igballe Rexha Jashari: Po, kanë ardhë n'kamë me pankarta, me veshjet {shpjegon me duar}, me... unë po thom emocioni shumë i madh ishte që ata edhe që na me nifarë forme kemi me i mbrojtë ata. Domethonë, gjithë ajo masa tjetër ishte sikur në mbrojtje të atyre njerëzve që kanë ardhë edhe në shërbim të tyre. Ata janë një në atë moment dhe ne në shërbim të tyre, çfarë ata të kërkojnë edhe ne jemi pranë tyre.

Anita Susuri: E masa si janë shpërnda pastaj?

Igballe Rexha Jashari: Masa edhe prej aty domethonë se ju kanë thanë që, "Do të realizohen këto pikat të cilat po i kërkon", dhe është shpërnda masa. Edhe pse s'janë realizu ato (qeshë).

Anita Susuri: Qato vite domethonë '89, '90 edhe ma tutje, po kryesisht këto dyja kanë qenë, ka pasë shumë ngjarje.

Igballe Rexha Jashari: Shumë.

Anita Susuri: Çka ju kujtohet diçka që ju ka mbetë kujtim ashtu?

Igballe Rexha Jashari: Jo, m'kujtohet domethonë tani vitet e '90-a fillojnë, fillon organizimi, daljet prej punës, natyrisht që edhe baba im që doli prej punës te greva e 3 shtatorit. Kom qenë pjesëmarrëse në atë grevë, natyrisht, domethonë që... n'qytet që ishte e përditshme faktikisht ato ditë edhe dalja prej punës masivisht e njerëzve.

Anita Susuri: E greva e minatorëve a ju kujtohet? A keni shkru ju për grevën?

Igballe Rexha Jashari: Për grevën e minatorëve unë konkretisht nuk kom shkru. Unë konkretisht jo. E di se ka qenë gazetari domethonë i Mitrovicës, kanë shkru edhe gazetarë tjerë, Behari ndoshta, domethonë...

Anita Susuri: Kanë qenë korrespondentë?

Igballe Rexha Jashari: Po, po kanë qenë korrespondentë prej secilit vend në “Rilindje”.

Anita Susuri: A ju kujtohet atëherë si është pritë kjo te ju, për shembull në redaksi ose në familje te ju? Në shoqëri? Çka është folë? Se ata aty janë mbyllë domethonë tetë ditë me kërkesat që i kanë pasë...

Igballe Rexha Jashari: Për neve ishte me rëndësi me shpëtu ata të gjallë, me dalë të gjallë, mos me i marrë faktikisht, mos me i burgosë faktikisht, domethonë edhe me dalë të gjallë prej aty. Sepse gjithmonë secili ndoshta edhe kur e përjeton ni moment të pritjes, edhe sot ni moment të pritjes, është e randë. Edhe për ne të gjithë edhe në familje, domethonë ishin edhe në familje edhe në shoqëri edhe në redaksi domethonë në pritje të asaj se mos po ndodhë diçka ma e keqe me minatortë të cilët janë brenda. Dhe qysh, domethonë ndoshta ditë e fundit edhe qysh s’po pranojnë diçka që s’paku të dalin të gjallë prej aty sepse mund të vdesin. U zgjat shumë ajo.

Anita Susuri: Ata e kanë marrë ni dokument që tregon se Husamedin Azemi...

Igballe Rexha Jashari: Pikat. Po, Aziz Abrashi.

Anita Susuri: Që Rrahman Morina ka dhanë dorëheqje.

Igballe Rexha Jashari: Po, po, ashtu është.

Anita Susuri: Nuk ka qenë e falsifikume, po pastaj është ndryshu.

Igballe Rexha Jashari: Osht’ ndryshu.

Anita Susuri: A e keni marrë ju si t’mirëqenë këtë dokument? A ju kujtohet? Apo keni dyshtu që ndoshta mundet me qenë...

Igballe Rexha Jashari: Mashtrim.

Anita Susuri: Mashtrim?

Igballe Rexha Jashari: Po, po. Kemi dyshtu, domethonë që mund t’jetë mashtrim ajo. Sepse si vazhdimisht domethonë unë thashë edhe në raste tjera ajo ka ndodhë që s’janë realizu ajo që osht’ thanë po s’paku deri në shpërndarje të masës apo deri, në këtë rast, deri në dalje të grevistëve jashtë.

Anita Susuri: Pasiqë është kuptu kjo, qysh ka qenë pastaj qëndrimi ju? Edhe deshta edhe diçka me ju pytë m’lidhet me këtë temë, a është ndiku, normalisht që është ndiku po sa është ndiku po m’intereson “Rilindja” prej Komitetit?

Igballe Rexha Jashari: E di që...

Anita Susuri: Edhe a është shkru?

Igballe Rexha Jashari: E di që thuhet kjo vazhdimisht, por unë mund të them si gjeneratë ndoshta kishim edhe shumë pak gazetarë që kanë ardhë ma vonë, por ishim gjenerata e fundit faktikisht që ishim pranë, në numër ma të madh të gazetarëve në “Rilindje”. Edhe me kolegët e mi që edhe tani bisedojmë, nuk na kujtohet që dikush, ndoshta edhe s’kemi hy në shumë ujëra ne, por nuk na kujtohet neve sepse kanë qenë direktiva tjerë edhe me persona tjerë ndoshta.

Po nuk m’kujtohet që dikush ka pasë në shkrimin tim që e kam ba. Edhe e kam përcjellë nuk ka pasë ndonji ndërhyrje të tillë, nuk kom pasë rast që ndonjini prej gazetarëve edhe [Zenun Çelaj](#) që e kom pasë redaktor edhe që dikush, domethonë ka thanë që, “Kjo nuk bën të shkruhet Igballe n’këtë rast”, nuk ka pasë, nuk kemi pasë. Ne s’kemi pasë. Ndoshta kanë qenë direktivat e personave tjerë që e kanë përcjellë faktikisht politikën, se ishim të ndarë.

Ne përcillshim ngjarje, por jo pjesën e Komitetit. Pjesën e politikës faktikisht kanë qenë gazetartë e caktuar që e kanë përcjellë. Ndoshta te ata, nuk e di domethonë. Por, te pjesa e kolegëve të cilëve edhe sot jemi edhe e diskutojmë këtë, se e dëgjojmë vazhdimisht që kanë pasë. Sigurisht me në gazetë shtetërore edhe ndikimi mund t’jetë domethonë, por nuk m’kujtohet që dikush m’ka thanë ndonjëherë, “Mos e shëno”. E di vetëm një rast kur unë kam qenë edhe në Lidhjen Demokratike të Kosovës në atë kohë që gazetartë nuk kanë qenë shumë, kanë qenë numër i vogël.

Ishte Xhemajl Mustafa, ishte Enver Maloku që ishin gazetarë, po nuk ishin shumë, domethonë prej “Rilindjes” edhe ndoshta si gru isha e vetmja. Thojshin që duhet me i nda këto gjana, domethonë mos me i përcjellë, se nëse je aty i përcjellë, i përçon gjanat në “Rilindje” në nifare forme. Por, une edhe në ato momente e kom rujtë atë pjesën zyrtare. E kom përcjellë aktivitetin meqë kom pasë mundësi, por e kom shënu si aktivitet, aq ka qenë. Përndryshe, ndonji ndikim nuk m’kujtohet, absolutisht që dikush m’ka thanë, “Mos e shkruaj këtë se s’bon”.

Anita Susuri: Deshta edhe me ju pytë për redaksinë e ju, keni mbajtur sigurisht mbledhje të...

Igballe Rexha Jashari: Të përditshme, të përditshme.

Anita Susuri: Qysh ka qenë kjo?

Igballe Rexha Jashari: Çdo ditë, domethonë takimi i redaksisë ka qenë i çdo ditshëm dhe janë nda detyrat. Është ba ni renditje e aktiviteteve të cilat duhet të përcillen po edhe propozimet janë dëgju propozimet prej gazetarëve nëse dikush ka pasë. E ka ditë ni ngjarje që do të mbahet edhe është n'dijeni edhe është shënu. Dhe janë nda, secili gazetarë. Fillimisht vullnetarisht kush don me shku në ngjarjen, po.

Ka ardhë kufoma prej ushtrisë serbe, për shembull në Rrezallë une kom shku e kom përcjellë. Ishte kufoma e parë faktikisht që osht' ardhë edhe kom shku e kom përcjellë ngjarjen se kom dashtë që me e pa vet atë. Edhe vullnetarisht i kemi ngritë gishtat kush don me shku, nëse domethonë s'ka pasë vullnetarë, atëherë domethonë është caktu prej redaktorit personat të cilët shkojnë me i përcjellë aktivitetet. Por, kryesisht ka pasë domethonë vullnetarë edhe n'ato ngjarjet e...

Anita Susuri: E n'atë, që m'tregutë për kto kufomat që kanë ardhë prej ushtrisë të djemve t'ri, kur keni shku atje si, nuk e di si me bo pytjen se m'duket shumë depresive po domethonë çka keni pa n'atë?

Igballe Rexha Jashari: Domethonë, kufomat e para kur kanë fillu me ardhë e pabesueshme ishte që dikush ka mund, domethonë t'i vras n'atë formë djemtë domethonë edhe pse ne kishim edhe ngjarje të mahershme n'këtë drejtim. Ishte rast i...

Anita Susuri: Po faktikisht shteti i ka vra ushtart e vet, se atëherë...

Igballe Rexha Jashari: Po, po, po. Edhe po nuk guxojshim të flitej. M'kujtohet që po them rasti i Rrezallës, flitej me persona shumë pak. Varrimi ishte shumë masiv po me ni rreth t'ngushtë që kjo ka ndodhë prej, domethonë atyre. Sepse edhe përcilleshin edhe ruheshin prej atyne edhe vazhdimisht ishte përcjellja shumë e madhe prej sistemit edhe flitej shumë n'grupe t'vogla. Domethonë që kjo ka ndodhë prej është vra taman, domethonë djali se ata siç thonin, domethonë ose ka bo vetëvrasje ose në forma të ndryshme. Kufomat që i kanë sjellë ishin [ngjarje] të randa shumë, shumë, shumë. Shumë të randa ishin ato momente kur domethonë vishin kufoma prej... edhe ne, domethonë kemi pasë edhe n'familje faktikisht. Domethonë, ishte ni djalë, nipi i nanës që domethonë erdhi kufomë erdhi prej atje.

Anita Susuri: A ka qenë i vramë, a si?

Igballe Rexha Jashari: I vramë ka qenë, i vramë ka qenë. Po ashtu Fatmir Krasniqi, domethonë që ishte vrasja ma e randë në Prishtinë edhe varrimi ma i madhi në Prishtinë që ka ndodhë vrasja e ushtarit Fatmir Krasniqit. Ishte aty dikund afër lagjës domethonë tonë. Plumbat në trupin e tij m'duket që sot po ia shoh, kom, domethonë absolutisht ishte vrasje, vrasje ishte.

Anita Susuri: Cila ka qenë, për shembull përgjigja për ata? Si ka vdekë?

Igballe Rexha Jashari: Asnihere. Kurrë. Për ata...

Anita Susuri: Dashta me u ndërlidhë me, ju m'tregutë që keni marrë pjesë edhe n'tubime që janë bo për pajtimin e gjaqeve, domethonë është marrë vendim që shqiptartë me u...

Igballe Rexha Jashari: Mos me pasë. Ishte ni vendim shumë i mirë, ishte ni punë shumë e mirë, ishte ni, për neve ni kënaqësi shumë e madhe që ndjeshim domethonë që shqiptarët po e falin njëri-tjetrin dhe po bashkohen në atë kauzë të përbashkët, që ishte kauzë e përgjithshme e popullit shqiptar n'atë kohë. Ishte e dhimbshme për ndonjenin që falte edhe katër gjaqe edhe ishte... po ishte një e mirë e përgjithshme dhe për hir të asaj... Megjithatë edhe emocione edhe lot kishte, jo niherë por pothuajse përherë kishte edhe lot sepse edhe falja s'ka qenë e lehtë. Domethonë nëse është vra ni i ri prej dikujt dhe ti t'ia falësh... por ishte kauza e përgjithshme që duhej, që u ba shumë shumë ni punë e madhe. Puna ma e madhe e këtij vendi m'duket, domethonë, ajo. E mira e këtij vendi që ka ndodhë ka qenë ajo, falja.

Anita Susuri: A keni shku vetëm nëpër tubime...

Igballe Rexha Jashari: Edhe tani mbas atij rasti që fali te varrimi për katër familjartë, domethonë ishte ni...

Anita Susuri: Ndeshje?

Igballe Rexha Jashari: Ndeshje që u bo. Sa mirë sepse s'ka të mirë prej mosfaljes. Vazhdoj me mendu, domethonë që prej mosfaljes s'ka asni të mirë, asni të mirë s'ka aty. Domethonë pësimi është përherë i njëjës apo tjetrës familje, në vazhdimësi kështu që...

Anita Susuri: A keni qenë vetëm nëpër tubime apo edhe nëpër oda për shembull?

Igballe Rexha Jashari: Kom qenë edhe në oda, kom qenë edhe në oda.

Anita Susuri: Si ju kanë pranë juve si grua, si femër?

Igballe Rexha Jashari: Si grua, tash unë, domethonë nuk kom dalë në vende të thella apo... kom marrë pjesë në Prishtinë kryesisht ku janë bo pajtimet e gjaqeve. Edhe m'u kujtu tani si grua, domethonë, se po dal krejt, kur osht' vra mësusi Halil Geci edhe kemi shku. Edhe më kujtohet, domethonë, tham, "Na si gra qysh kemi me u pranë tash?" Edhe ai i zoti i shpisë, thotë, domethonë, "Ju uleni", si me thanë në kry të vendit.

Edhe filloi me fjalimin, m'duket që po e shoh atë burrë, domethonë, thotë, "Tri shtyllat e kësaj shtëpie jeni ju", domethonë, tri shtyllat, "Ni shtyllë na jemi, kështu që ju e keni". Se ne tham nuk po e prishim

rendin se ishte plot. Domethonë, “Vazhdoni ju, na ulemi n’këtë pjesën”, “Jo, jo, ju jeni tri shtyllat e shtëpisë përherë, ne jemi një edhe ju duhet ta keni vendin e juaj”. Se ishte edhe ajo mikëpritja osht’.

Mendoj që ajo ka qenë ndoshta në thyrje e atyne që, zakoneve të mahershme që kanë qenë. Kur jemi te zakonet, se po dal tash, nana ime kur ishte martu kishte pas hy në odë, domethonë oda e burrave e kishin pas shty familja që ti do t’jesh nusja që, domethonë do t’jesh në odë përherë. Sepse familjet kishin qenë, familja e nanës po edhe familja e babës, domethonë ka qenë në familje e ngritun n’atë kohë, sepse kishte qenë shkolla në shtëpinë e tyre. Shkolla fillore në shtëpinë e tyre. Dhe kur janë miqësu si familje e kanë njoftë, domethonë, faktikisht edhe ngritjen edhe kthjelltësinë edhe e zgjuar... nana jeton ende. Është shumë e zgjuar, domethonë, shumë shumë edhe që, rrallë njerëz shoh, jo që e kom nanë, por rrallë njerëz shoh që janë ashtu me atë kujtesë çfare e ka.

Dhe ashtu ishte, domethonë, disi nuk, këtë hyrjen s’më kujtohet diçka që ka qenë e vështirë, hiç s’më kujtohet ndonjë vështirësi për me hy atëherë. Sepse njeriu, unë mendoj që nëse je ballëhapur, nëse e ki qëllimin e mirë, domethonë edhe e ke qasjen, s’ka ndonji arsye pse t’jetë ajo. Domethonë, s’më duket normale.

Anita Susuri: M’interesoi nana e juj çfarë gjenerate është?

Igballe Rexha Jashari: ‘36.

Anita Susuri: ‘36. Shumë mirë.

Igballe Rexha Jashari: Shumë.

Anita Susuri: Për vitet e ‘90-ta, kisha kalu. M’tregutë për pajtimin e gjaqeve, pastaj pason edhe dalja nga puna e shumë...

Igballe Rexha Jashari: Punëtorëve, numrit ma t’madh të punëtorëve.

Anita Susuri: Ndërmarrjeve. Ju sigurisht keni shkru në redaksinë e juj për t’gjitha kto.

Igballe Rexha Jashari: Po edhe neve na është ndalu “Rilindja” faktikisht.

Anita Susuri: N’cilin vit “Rilindja”?

Igballe Rexha Jashari: ‘90-ën, po, është ndalu “Rilindja”, është ndalu Radio Prishtina, është ndalu menjëherë “Rilindja”, domethonë pas ni muji e gjysë ashtu është ndalu “Rilindja”. Dhe ne derisa jemi organizu dhe kemi diskutu ka kalu në periudhë kohore. Domethonë, që kemi dalë me emrin “Bujku” se vetëm n’atë formë, domethonë u dashke, u leju me dalë edhe me dalë si “Bujku”. Natyrisht u pajtum që

t'mos jetë "Rilindje" titulli, por s'paku t'jetë ni dritare informimi për popullatën edhe mos të shuhet plotësisht.

Anita Susuri: A keni qenë ju aty? A kanë ardhë në redaksi apo si ka ndodhë mbyllja?

Igballe Rexha Jashari: Po, po. Kanë ardhë n'redaksi po kanë ardhë te krye redaktori, domethonë, edhe kanë thanë, "Ma nuk bon me u shkru". Ka ndodhë edhe ni kacafytje po ashtu n'hyrje edhe jashtë kur kemi dalë edhe kanë qenë ato peripetitë. Domethonë, edhe kur osht' mbyllë gazeta. E di që kur osht' dalë dikush osht' ndalu që të, "S'guxoni ma të shkruani", edhe, "Ju s'jeni ma gazetarë", edhe kjo. Po mandej ajo marreveshja që del gazeta si "Bujku". Atëherë kemi dalë, domethonë si gazetar të "Bujkut".

Anita Susuri: Si ka vazhdu tani, a e keni ndrru redaksinë? A keni nejtë?

Igballe Rexha Jashari: Nuk kemi ndrru asgjë, vetëm emri ka ndryshu, domethonë nuk kemi ndryshu asgjë. Ka vazhdu domethonë, me, në të njejtën formë të gjithë gazetarët si kemi qenë domethonë vetëm emri është ndrru i gazetës.

Anita Susuri: A keni pasë pastaj probleme për shkrimet e juja?

Igballe Rexha Jashari: Kemi pasë probleme në shkuarjen e marrjes së informatave, domethonë. Kemi pasë shumë shumë probleme. Janë rreh sa gazetarë. Unë, nuk m'ka ndodhë ajo, m'ka ndodhë domethonë që faktikisht nëpër ato punktet, nëpër plumba e me shku me u mshefë në ni familje m'kujtohet në Ferizaj, domethonë, që ka vdekë prej torturave ai i burgosuri, sa u burgos edhe shkova n'atë familje. Thanë, "Erdhën policia se po e dijnë që ti si gazetarë je brenda".

Edhe aty e di që ata e kanë zbrazë millin në magje edhe kanë thanë që, "Do t'fusnim ktu, në këtë magje, që mos t'kapin policia". Po e kishin pasë gjetë ni hyrje tjetër me kalu prej ni shtëpije në shtëpinë tjetër. Dhe materialet i kom lanë aty, domethonë, në magje aty në atë magje në mill ndërsa, domethonë vet m'kanë qit prej shtëpisë në shtëpi disa edhe kom qëndru disa orë, domethonë aty deria osht' bo mramje. Shoferi ka pritë në anën tjetër dhe pastaj, domethonë kemi dalë pa pasoja.

Kanë ndodhë kështu shumë e shumë raste, shumë e shumë raste, por faktikisht unë s'kam qenë, domethonë personi që ndonjëherë policia më ka rrahur. Jo.

Anita Susuri: A keni pasë problem ndonjëherë direkt me policinë për shkak t'profesionit?

Igballe Rexha Jashari: Direkt, në punkte po, në punkte. Ai arsyetimi derisa t'lirojshin a po t'marrin a po t'lshojnë, domethonë ajo ishte po vazhdimisht, domethonë. Ni herë m'kujtohet në punktin e Komoranit që ishte, punkt më famkeq m'duket në Kosovë. Ma famkeqti ishte sepse ishte udhëkryq

faktikisht i të gjitha rrugëve që të sillnin në Prishtinë edhe vishin prej Gjakovës. Unë edhe Elviana Behrami, domethonë edhe shoferi Faiku, zotëri Faiku na ndalën aty, na kanë mbajtur disa orë. Nuk... materialet natyrisht që na gjenim forma për materialet për mos me i...

Anita Susuri: Mos me ra në dorë.

Igballe Rexha Jashari: Po, absolutisht. “Pse keni shku? Arsyeja?” Domethonë, edhe e gjetën ni arsye që shoferi ishte në leternjoftim pa mustaqe, ndërsa ai kishte mustaqe. Edhe thanë, “Ju duhet të ktheheni atje në Gjakovë ku keni shku për informacione. Atje ky ka me shku me i heq mustaqet edhe vazhdoni rrugën”, a din, pas disa kohe. Atëherë m’kujtohet, domethonë, Elviana thotë, “Jo, nëse vetëm kjo është arsyeja une e Igballja me dorë kemi me ia hjekë mustaqet edhe vazhdojmë”, se nuk ish koha ma, ishte mramje, domethonë me u kthy në Gjakovë. Edhe ata fillun pak ashtu si me (qeshë)... mandej pasi u konsultuan ndoshta thanë, “Ne”, domethonë, “këtë punë mujmë e bajmë, veç thuna që, na kemi me ba këtë punë. S’ka m’u kthy”. Edhe na mbajtën edhe disa kohë, aty në punkt domethonë, jo, po aty në punkt mandej na lirin prapë.

Anita Susuri: E para se me vazhdu n’vitet e ‘90-a deshta me iu pytë për jetën personale, domethonë si jeni njoftu me bashkëshortin? Kur jeni martu? Si jeni martu?

Igballe Rexha Jashari: Okej. Bashkëshorti im m’kishte njofur faktikisht shumë ma herët domethonë se sa që unë e kam njohur. Është, ata janë prishtinali, domethonë janë muhaxherë të Toplicës edhe në Prishtinë. M’kujtohet që tha, “Sa e përgatitsha vetën me t’dalë para”, unë kam ecë shpejt, gjithmonë domethonë edhe qytetit kom ecë shumë shpejt. Thotë, “Atëherë e nalsha vetën që” (qeshë) edhe n’bibliotekë m’kishte pa, por unë nuk e kom njohur faktikisht domethonë.

Motra ime, kjo e ndjera, punonte në kioskun përpara Shtëpisë të Mallnave, po meno përpara Shtëpisë të Mallrave të Vjetrës edhe n’atë kohë edhe ajo u pat punësu thuajse në të njejtën kohë në vitin ‘87. E ishte kiosku, kiosk, qendër sepse i gjithë materiali ilegal ishte n’atë kiosk aty. Edhe ajo ka qenë ni bartëse e atyne informacioneve faktikisht. Alternativat [politike] që u votojshin në Slloveni, domethonë vishin aty edhe prej aty u shpërndajshin njerëzve.

Motra ime e kishte njohur domethonë se ai ka qenë i rregullt në blerjen e gazetës. Edhe, por ajo s’ka qenë ajo që m’ka thanë. Rastësisht ky vjen te shoqja ime, kolegja në “Rilindje” po e kisha edhe shoqe të gjeneratës në gjimnaz, domethonë ishim bashkë prej gjimnazit me atë që ishim aty në “Rilindje”. Edhe ky vjen me i kërku diçka asaj edhe befasohet domethonë që m’sheh mu aty se nuk e ka ditë ku unë jom, ku kom mbetë (qeshë). Edhe i kishte thanë edhe thotë ajo, domethonë, thashë, “Jo s’vjen shprehje, çfartë, jo, nuk du”.

Kaloi ni kohë, pritën pak ashtu edhe fillum me dalë, domethonë që ishte viti ‘88 faktikisht domethonë masiqë unë veç kisha hy në “Rilindje”. Edhe kështu ata jetun, po mendoj, kanë jetu se unë tash jetoj në

lagje të Universitetit ka 20 vite po ktu te parku i qytetit (qeshë). Edhe m’thoshte vjehrra, thashë, tha, “Kaq afër n’shkollë ke qenë ke mujtë me ardhë me pushu, kaq afër n’fakultet ke mujtë me ardhë me pushu ktu”, edhe, a din qysh, “Nuk e ke njohur gjatë asaj kohe”.

Jemi martu, ni familje edhe ata sikurse na domethonë, ishin vetëm fëmijtë me vllazër e motra me prindërit kur une u martova. Kemi jetu dhjetë vite në bashkësi familjare, faktikisht aty. Gjithë aktiviteti im gjatë asaj kohe ishte i asaj shtëpie faktikisht sepse isha, edhe kur isha kryetare e Forumit të Gruas të Kodrës të Trimave, fillimisht mandej isha kryetare e degës të dytë se i takojsha kësaj lagje në Prishtinë, përveç që isha në Kryesi të Forumit të Gruas të Kosovës, domethonë gjithë gazetarinë... m’kujtohet ata taksistat aty te Grandi domethonë se m’bike për çdo ditë rruga aty edhe njini tha, “Kjo çdo ditë vonohet për punë se gjithmonë vrapon” (qeshë).

M’rrin ashtu. U ktheva me pa, “Kjo gjithmonë vonohet për punë. Vazhdimisht osht’ duke vrapu” (qeshë). Ajo rrugë ishte që unë e bojsha, domethonë prej mas Shtëpisë të Mallnave edhe, domethonë e bojsha vazhdimisht për “Rilindje” (qeshë).

Anita Susuri: E si ka qenë, nëse doni me na tregu, dasma, për shembull, si është bo dasma ju?

Igballe Rexha Jashari: Po. Dasma, meqë unë isha fëmija i madh domethonë, në familje edhe burri im po ashtu është fëmija i madh në familjen e tij, ne nuk ishim shumë për dasmën domethonë, edhe ishte situata faktikisht domethonë. Ishte viti ‘89 që ne u dashke me ba dasmë edhe ishte koha e vështirë. Edhe ai ishte pjesëmarrës i vazhdueshëm nëpër ato që ka ndodhë demonstratat. Ai ka qenë student i Gjuhës shqipe, faktikisht e ka kry atëherë Gjuhën shqipe, por ishte punësu në KEK si student dhe ka vazhdu me punu në KEK tanë kohën, si laborant i kimisë edhe pse e kishte Gjuhën shqipe.

Edhe domethonë nuk ishim për dasmën me e ba, por është ba dasmë tamon domethonë edhe n’familjen time. Ai organizimi i vajzave domethonë i shoqërisë time, i kom ftu n’shtëpi domethonë shoqinë time komplet ni natë. Ajo ka qenë kryesorja atë natë. Kur i kam ftu shoqinë kanë ardhë edhe familjarë tjerë edhe te une e kom fjalën domethonë. Ndërsa te këta është ba dasmë tamon prej ditës domethonë të ejtës qysh janë organizu edhe n’telefon, ata telefonat e dorës që ishin domethonë, “Qe çfarë muzike”, kunata m’thirrke, vajzat e axhës e ashtu domethonë edhe unë mërziya ishte domethonë, s’e di as sot. Po e di që kom hy n’dhomë edhe kom qajtë shumë (qeshë). Derisa domethonë t’gjithë, “S’duhet, s’duhet”.

Anita Susuri: Ju keni qenë e para prej vajzave që jeni martu?

Igballe Rexha Jashari: Unë fëmija i madh, pas shtatë vite martesë unë isha fëmija i madh edhe...

Anita Susuri: Po, po. A keni qenë e para që jeni martu, po?

Igballe Rexha Jashari: E para që isha martu, po, po. Edhe e para që u martova edhe e hanja, dita domethonë, mandej ato tri ditët kanë vazhdu e mërkurja, tri të mërkuret e ashtu. Ni muj ditë kom qenë jashta vetës, muj me thanë, jashta vetës. Komplet domethonë diçka tjetër. Mas ni muji, edhe atë ditë kur u martova ashtu e kom pasë ni moment m'erdh, jo t'fikët. E kur shkova e thirrën nanën tem n'telefon. Nana, "S'duhesh, duhesh me u qetësu". Burri jem, "Po n'qit shpi ke ardhë sa here, nuk është e para herë që je kah vjen ktu". Ishin ato domethonë t'dasmës. Dhetë vite s'kom pasë fmi. Faktikisht lutesha që t'mos kem fmi se isha tanë kohën në aktivitete e angazhume, po s'ishte mirë ashtu. Kështu që, djalë e kam, e kam një djalë n'vitin 2000, domethonë pas luftës. E tani është 20 vjeçar, student i vitit të dytë në Menaxhment, Ekonomi domethonë.

Pjesa e Tretë

Igballe Rexha Jashari: Prej organizimit të parë të shoqatës së gruas në platonë e Pallatit të Rinisë, domethonë, prej aty jam aktivizu. Faktikisht, domethonë edhe takimet që janë mbajtur sidomos në Lagjën e Muhaxherëve, takimet nëpër shtëpia të grave kom qenë domethonë pjesë e takimeve nëpër shtëpia para se të organizohet shoqata e gruas domethonë edhe para asaj daljes. Kjo që fillun iniciativat për m'u themel. Jom aktivizu në pjesën e grave, domethonë s'jam aktivizu direkt në pjesën e burrave siç ka qenë motra ime, domethonë prej fillimit aty po unë kom qenë në pjesën e grave edhe n'ato organizimet e para të grave dhe themelimit të shoqatës domethonë kom qenë prej fillimit aty.

Anita Susuri: Si është organizu atëherë? Çfarë...

Igballe Rexha Jashari: Motivi.

Anita Susuri: Plani keni pasë atëherë?

Igballe Rexha Jashari: Po, motivi domethonë që ne t'gjejmë forma t'organizimit dhe a të organizohemi vetëm si gra apo t'jemi pjesë e ni subjekti politik siç ishte LDK-ja, domethonë kjo ishte e diskutueshme disa muj gjatë asaj kohe. Sepse nevoja për organizimin e grave edhe të grave ishte, domethonë që edhe gratë të bajnë diçka duke nisë nga të drejtat e fëmijëve. Ky ishte, domethonë motivi kryesor që ne t'i mbrojmë fëmijtë tanë, domethonë n'atë kohë, si gra, si nana, domethonë t'mbrojmë fëmijtë e tanë. Edhe t'organizohemi edhe n'pjesën shëndetësore edhe arsimore, analfabetizmi.

Edhe ishin disa qasje domethonë që ty t'shtyshin në themelimin apo në grupimin edhe të grave në veçanti përveç Lidhjes Demokratike si Lidhje Demokratike që ishte. Dhe pas disa, domethonë takimeve dhe duhet apo s'duhet të jemi mrena subjektit politik, megjithatë u arrit. Dashtë e pa dashtë ishte nifarë forme e punimit që ne t'jemi pjesë, të organizohemi bashkë, mos t'jemi veçantë prej Lidhjes Demokratike dhe të organizohemi në Forumin e Lidhjes Demokratike të Kosovës.

Isha, natyrisht që isha me gratë e... në organizimin e takimit të parë të Forumit të Gruas në Kuvendin e Parë, domethonë gjithë punën e kom bo, gjithë aktivitetin e kom bo n'atë kohë për atë organizim të Kuvendit të Parë të 24 gusht [1990] domethonë që u mbajtë në shkollën Asim Vokshi, Kuvendi i Parë në atë frymë. Pas pajtimit që ne jemi domethonë pjesë e subjektit politik edhe t'jemi si Forum i Gruas brenda Lidhjes Demokratike. Atëherë domethonë kemi filluar aktivitetin në përgjithësi në të gjithë Kosovën muj me thanë, mos t'them vetëm Prishtinën.

Në atë kuvend kanë marrë pjesë gratë nga Shqipëria, gratë nga Maqedonia, gratë nga Presheva. Unë kom dalë n'kufi domethonë që t'i pres gratë nga Shqipëria, që ka ardhë në delegacion i madh i grave nga Shqipëria dhe kënaqësinë po ashtu. Kënaqësinë e tyre nuk e harroj që edhe ato sikurse ne që kishin emocione për m'u fut në atë anë të kufinit edhe ato domethonë atë kënaqësinë e tyre që ato janë fut në tokën e Kosovës dhe po vijnë të marrin pjesë në në kuvend të Kosovës ishte shumë i madh, shumë.

Kanë qenë ndoshta 15 gra domethonë që kanë ardhë prej Shqipërisë. Jemi organizu që ta marrim secila nga dikë në shtëpi edhe unë kisha domethonë Sevim Arbanaj ishte njëra prej grave që ka ndëjtë te une tri netë në familje. Dhe kështu u organizum të gjitha gratë që të marrim nga dikë sepse ti me i vendosë në... s'kishe ku i vendosë, domethonë gratë në atë kohë... hotelet s'ishin domethonë ma edhe gratë nëpër shtëpia

Anita Susuri: Po m'duket që është bo, n'mënyrë ma diskrete është mendu me u bo sepse ka pasë problem edhe...

Igballe Rexha Jashari: Ka pasë probleme policia. Ka ardhë policia e ka marrë [Flora Brovinën](#) domethonë që ishte udhëheqëse n'atë kohë. E ka marrë edhe Anton Kolaj që ishte domethonë njëri prej anëtarëve të Kryesisë të Lidhjes Demokratike. I ka çu në biseda informative domethonë atëherë dhe më pastaj domethonë ka vazhdu punimet e kuvendit. Është zgjedhë Kryesia e Parë e Forumit të Gruas ku isha edhe unë domethonë njëra prej tyre. Ka vazhdu organizimi në degë, nën degë. Po ashtu edhe vet Prishtina e kishte në kryesi si Prishtinë domethonë. Ishte Shqipe Dumoshi kryetare e Forumit të Gruas të Prishtinës, unë isha nënkryetare e Forumit të Gruas të Prishtinës. Si Prishtinë, të gjitha degtë domethonë që ishin, megjithatë ishte edhe në kryesi, domethonë plus që t'boj atë koordinimin e degëve të Prishtinës.

Ishin aktivitete të ndryshme shëndetësi, domethonë, arsimimi, ndihma, bashkëpunimi me Shoqatën Nënë Tereza që ka qenë i vazhdueshëm, hapja e atyne ordinancave domethonë që ishte edhe para pak kohe i shfeltova sepse m'u kërkun prej [Adnan Mervocit](#) do informacione dhe e pashë që, domethonë edhe kur e kam hapë ambulancën në Lagje të Kodrës të Trimave ishin, domethonë edhe ato çka kemi dërgu atje edhe të gjitha. Ni tavolinë, ni dollap, ni domethonë, ishin të gjitha çka kemi dërgu në atë kohë. Aktiviteti ishte shumë i madh, shumë i, vullneti shumë i madh, s'e di, domethonë, s'e di, gjumi, domethonë, që bëhej dhe, tanë kohën ishte...

Unë isha edhe me pjesën e gazetarisë natyrisht, domethonë që ishte edhe pjesë edhe që më ndihmonte në nifare forme që t’jem gjithëkund në ato ku unë dëshiroja. Edhe domethonë në formën e po... edhe pjesë e aktivitetit të vazhdueshëm domethonë që... ishte shumë i madh.

Anita Susuri: Gjatë ‘90-ave ka pasë edhe shumë demonstrata që janë organizu prej Forumit të Gruas, ka qenë me letër t’bardhë...

Igballe Rexha Jashari: Me letër t’bardhë, po.

Anita Susuri: Ka qenë me bukë.

Igballe Rexha Jashari: Ashtu, me bukë.

Anita Susuri: A ju kujtohet, sigurisht ju kujtohet po...

Igballe Rexha Jashari: Po, kom qenë pjesë, domethonë të gjitha [protesta me sllogan] holokaustit, domethonë, organizimi i holokaustit që janë t’gjitha ato fotot domethonë edhe jam aty. Po, ishte ni...

Anita Susuri: Si ka ardhë idea atëherë?

Igaballe Rexha Jashari: A si ka ardhë idea, domethonë që ne t’gjejmë forma për organizimin. Po pas diskutimeve që po ndodhin kto e kto që ne duhemi t’lëvizim, që duhet t’masivizohemi që, domethonë ti natyrisht që gjithmonë e kishe në ndërdije që ballafaqimi do t’ndodhë. Domethonë, ajo ishte përherë, që do t’ndodhë ballafaqimi edhe me policinë edhe me... po që ti s’kishe rrugë dalje tjetër. Ti duhet me vepru, duhet me lëvizë, domethonë për mbrojtjen e gjithë atyre që ndodhshin edhe gjatë asaj kohe ndodhshin domethonë burgosje, vrasje, të vazhdueshme ishin në Kosovë. Ishte malltretimi shumë i madh. Ishte punkte që, domethonë, moslëvizja jote, gjithçka domethonë e shtypur edhe ti duhesh t’gjejshe forma, domethonë që t’organizohesh. Kjo me bukë ishte, domethonë pas fillimit t’luftës që ishte ni motiv tjetër, domethonë që ti t’ju dërgon atyne.

Ngritja, po mendoj, protesta me letra t’bardha ishte ngritje zërit që të ndëgjohet domethonë edhe të tjerët se ishte para Ambasadës Amerikane, domethonë. Ktu e bonëm pikënisjen që ajo t’jetë një, që ambasadat tjera, që t’dëgjojnë shtetet tjera, ta dëgjojnë edhe zërin e gruas domethonë, që ne t’jemi ni... t’mos mbesim ashtu... si e shifshë që po mbetësh pak si në harresë të errët atëherë një ngritje që ti je ktu brenda dhe që ti po përjeton, domethonë, gjanat.

Kur u grumbullun, domethonë, u dëgjum me telefona personat që ishin, domethonë ma kyç e morëm njani-tjetrin n’telefon dhe ktu është pikëtakimi, ktu do të takohemi. Secila me marrë gra, domethonë

me thirrë gra sa ma shumë. Kush n'lagje, domethonë kush një, domethonë, "Merri dhetë gra. Eja!" Domethonë, merri kështu edhe kështu përnihërë, domethonë ka ndodhë shumë shpejt, shumë shpejt.

M'kujtohet që brenda dy-tri orëve, domethonë osht' bo organizimi i... sepse edhe me ju lanë kohë ktyne organizimeve nuk bonte. Ishte rreziku, domethonë shumë i madh që ti, domethonë t'organizojë diçka për nesër dhe ndërkohë s'vishin personat t'cilët po organizojnë. Kështu që, domethonë organizimet ndodhshin shumë shpejt, aty për aty. "Po, do të dëgjohemi" domethonë, "thirre këtë, thirre atë". Edhe përnihërë domethonë veç vishin gratë lumë prej t'gjitha pjesëve të qytetit edhe u grumbullun shumë shpejt aty.

Ni delegacion mandej u caktu që t'hy brenda edhe t'bisedon me Ambasadën Amerikane edhe që t'ju tregojnë ato që po ndodhin, ato që po bohen. Jo që ata nuk ishin në dijeni, por s'paku të mbetej diçka e shkruar dhe diçka që ne jemi gjallë, domethonë dhe duhet t'ndihemi gjallë. Kjo ishte.

Anita Susuri: Po m'duket që demonstrata me bukë ka qenë e vetmja me incident. A ju kujtohet ajo ditë qysh ka nisë?

Igaballe Rexha Jashari: M'kujtohet shumë mirë, po si jo. Ishim prej fillimit, prej organizimit, domethonë deri në momentin kur u ndërpre shkuarja me bukë. Ishte, domethonë, ishte kah t'përcaktohem, cila është rruga që ne ta zgjedhim që t'vazhdojmë. Kjo ishte ni dilemë që shkaktoi edhe te gratë mandej ni huti që kanë zgjedhë edhe rrugë të tjera për, domethonë me ju bashku kolonës t'madhe që ishim ne kah hekurudha domethonë që shkojshim n'atë pjesë, isha...

Anita Susuri: Ku i morët buktë ma së pari?

Igaballe Rexha Jashari: Buktë i sjellnin, domethonë, absolutisht, veç kur i shishim me qese të gjithë furrtarët, domethonë që... solidariteti ishte maksimal ishte. Atë që dikush e kishte ose dikush që mendonte që është në shërbim apo në të mirë të përgjithshme, domethonë pa hezitim secili e bonte edhe shpërndarja... buktë veç kur e shishe që vishin (qeshë) edhe sa nuk u dashin, domethonë, aty. Secila, kur tham që me bukë do t'organizohemi, domethonë edhe kanë ardhë gra prej pjesëve të ndryshme te furra janë furnizu me qese të bukës, domethonë edhe ka pasë mjaftueshëm për të gjitha gratë pa hezitim bukë. "Bukë për Drenicën" domethonë që ishte, kishte fillu lufta, ishte ni faktikisht ni zonë ma e izolume prej tjerave që bahej lufta.

Edhe unë edhe si gazetarë që kam shku sa e sa herë m'u ka thanë që, "Pse", domethonë, "ju po rrini në Prishtinë?" Domethonë, "E ne përderisa", domethonë, "po përjetojmë të gjitha këto edhe po bojmë luftën edhe ju po rrini", domethonë, m'u ka thanë edhe mu personalisht. Unë për mos ta kalu këtë pjesë, domethonë në vitin '91 kur ka ndodhë sulmi në Prekaz kam qenë unë e vetmja me Flora Dokun, domethonë, që kemi shku në këmbë në atë kohë në familjen e Shaban Jasharit dhe ju kemi dërgu

ndihma në barna. Domethonë, se Flora Doku ishte gjinekologe, po ajo m'kishte kërku në "Rilindje", domethonë disa ditë edhe ni ditë kur u takum fillum bashkë që t'punojmë.

Kur ndodhi e Prekazit, domethonë, erdhi e m'tha, e kishte veturën dhe, "A je e gatshme", domethonë, "me qenë me mu në Prekaz?" Ishte borë e madhe për ata u dashtë ta lajmë veturën shumë larg, diku në Skenderaj që nuk m'kujtohet ku dhe kemi ecë në kamë derisa kemi shku në familjen e Shaban Jasharit. Ju kemi dërgu disa fasha, disa që ishin sepse atij ia kishin dëmtu syrin edhe ato mandej malltretimet tjera që ju kanë ndodhë familjes komplet. Por, jo vetëm asaj familje, ishin edhe familjet afër aty që ju kishin ndodhë. Kemi shku edhe te familjet tjera, ju kemi dërgu disa materiale shëndetësore domethonë atyre n'atë kohë.

Anita Susuri: Ju, si gazetare a keni shkru për t'gjitha këto ngjarje?

Igaballe Rexha Jashari: Intervistën që kam ba me të ndjerën Zarife, domethonë, nanën e Adem Jasharit nuk e kom publiku asnihere. E kom dorëshkrim, s'e kom publiku. Në atë kohë nuk lejohej, domethonë.

Anita Susuri: Ende nuk e keni publiku?

Igaballe Rexha Jashari: Ende nuk e kam publiku.

Anita Susuri: Pse?

Igaballe Rexha Jashari: Pse? Domethonë, tash pse, se e ruaj për ditën, domethonë kur vjen koha e vitit kur ka ndodhë '91-tën domethonë ajo, nuk du n'kohëra tjera dhe ajo prapë kalon. S'e kom botu asnihere, domethonë. Kom sa materiale të ndryshme t'cilat mendoj që (qeshë), po janë shumë.

Anita Susuri: Po e keni plan?

Igaballe Rexha Jashari: E kam n'plan, absolutisht, po. Po e kom plan.

Anita Susuri: E çfarë njerëz kanë qenë ata familja Jashari? Si ju kanë pritë?

Igaballe Rexha Jashari: Na kanë pritë, m'kujtohet ajo gru, thom, që e kom bo intervistën me të që thonë vërtetë bukë, kripë e zemër kom pa aty. Jo që, ata kanë qenë materialisht mirë, domethonë, kanë qenë materialisht mirë, kanë pasë kushte t'mira edhe n'atë kohë, domethonë m'kujtohet kur kemi hy ashtu. Po aty ishte një e veçantë, domethonë ato pushkët që sot i shoh i kom pa atëherë, domethonë, '91-tën. Ishin ato pushktë e varura. Ishte ajo gru, domethonë që... edhe gratë, edhe gratë ishin ndryshe prej të tjerave, se ishin shumë të vullnetshme për me punu n'atë drejtim, për me

bashkëpunu, t'gjitha ato edhe... te Shaban Jashari, domethonë shoh njeriun e veçantë, njeriun e veçantë.

M'kujtohen ato fjaltë e tij. E pritëm se ai kishte shku n'kontrollë mjekësore për syrin, domethonë që e kishte me fashë atëherë prej malltretimit dhe pritëm derisa u kthy, domethonë m'kujtohen ato fjaltë. Mandej e kuptova vonë se ai kishte qenë mësues, se unë u befasoja me fjalorin e, domethonë të diturat e tina në përgjithësi e ai kishte qenë në mësues, domethonë, i asaj kohe që për mu përshtypjen e veçantë e kam për atë njeri. Të veçantë me fjaltë me t'gjitha ato, domethonë që edhe neve na motivonte. “Jo, kjo s'është asgjë”, domethonë, “Nuk ka ndodhë kurgjo. Kjo s'osht”, domethonë, “duhet, ne jemi ktu, n'këto troje”. Kështu ato fjalë, a din, pavarësisht t'gjithë asaj që s'ishte atëherë shumë, se ishte '91 po ishte malltretim. Faktikisht ishte ndër familjet e pakta që edhe ju kishin hy ashtu edhe i kishin malltretu.

Anita Susuri: Po kthehna edhe niherë te pytja për gjithë ato ngjarjet e viteve '90-ta, për çka keni shkru, për shembull, çka keni lanë anash që...

Igaballe Rexha Jashari: Këtë intervistë, domethonë që s'e kam shkru si material ka qenë muj me thanë e vetmja që s'e kam shkru, si intervistë që e kam ba. Kom shkru, ku kom shku, domethonë kom shkru për Likoshanin. Kom shku në Likoshan nën plumba, nën përndjekje t'policisë atë ditë mezi kemi shpëtu, kemi hy maleve për me shku në Likoshan. Faktikisht ishte dy ditë mas ngjarjeve që ka ndodhë Likoshani. Kur kemi shku, bashkë me dy gazetarë tjerë dhe kur e kemi pa policinë që na u ka vu në përndjekje, domethonë atëherë kemi hy nëpër male me atë veturën derisa kemi hasë në një shtëpi e kemi lanë veturën.

Këto kanë qenë, domethonë të veçantat që kam shku nëpër plumba, domethonë duke i ra kështu {shpjegon me duar} edhe veç sa s'i bijnë veturës ka ndodhë disa here. Rrugën prej Fushë Kosovës deri te punkti i Komoranit aty n'atë pjesë kur ka ndodhë, domethonë dy herë që nuk e di si kemi shpëtu. Plumba aq shumë sa ka pasë, domethonë në veturën e... se e kishim *press* [gazetarë], natyrisht e kishim *press*, ajo edhe u dallojke prej kumeditë ku edhe plumba që ka pasë.

Pastaj përndjekje të ndryshme në ni ngjarje, në ni rast në Kaçanik po ashtu që kemi shku, nuk m'kujtohet fshati se ka qenë shumë shumë maje t'fshatit vetëm ajo shtëpi. Ishte vra, ishte burgosë, domethonë personi që kishte ardhë prej ilegalitetit atë natë dhe pas tri dite prej malltremeve vdes, domethonë ai person. Edhe kom shku aty edhe aty policia na ka përcjellë po ashtu edhe kemi qëndru shumë gjatë në shtëpi për mos me dalë derisa e kemi pa që ata janë largu, domethonë pak prej aty. Këto kanë ndodhë shumë shumë herë.

Anita Susuri: E në redaksi a ka pasë, për shembull, për ndonjë artikull që ka ardhë policia?

Igballe Rexha Jashari: Për ndonjë artikull jo, policia nuk ka ardhë, domethonë kryeredaktorin ka mujtë me thirrë, domethonë po jo ashtu. Edhe gazetartë ku i ka zanë ka pasë gazetarë të rrahur, domethonë sa shumë gazetarë ka pasë t'rrahur, por unë s'e kam pasur atë... unë s'kam qenë në pjesën e tyre. Ka pasë gazetarë të rrahur. Ka qenë Behar Zogiani shumë i malltretum, domethonë që sa kohë ka ndejtë edhe n'lëkurë, domethonë për me iu shëru plagtë. Ka pasë gazetarë të...

Anita Susuri: E a keni pasë ju ndonji lloj frike apo diçka që mundet me iu... non stop keni qenë...

Igballe Rexha Jashari: Ka qenë... po, ka qenë, frika ka qenë, por nuk ke pasë ku shkon, a din, prej asaj që e ke zgjedhë. S'ke pasë, domethonë, është dashtë tash. Të thuash që dikush tjetër t'përballet me këtë dhe unë t'mos përballem nuk ka ndodhë. Nuk kom qenë personi që kisha thanë, domethonë asniherë që le t'përballet dikush tjetër me këtë gjendje jo une, domethonë.

Në vitin '97 m'u ka burgosë motra, domethonë ajo ka qenë në Kryesi të Lidhjes Demokratike n'atë kohë, kryesinë qëndrore edhe protestat, demonstratat, protestat e '97-tës ka qenë edhe vllau faktikisht njëri ndër pesë organizatorët, domethonë edhe bisedat që i ka bo me Rugovën për, domethonë, për ato demonstrata edhe kemi qenë gjithë familja komplet, domethonë, vazhdimisht nëpër këto (qeshë).

Saqë nana ime nganjëherë thom qysh ka shpëtu. T'gjithë ishim, domethonë derisa u mblidhshim ne, domethonë ajo pa zemër ishte normal. Kanë qenë ato kohë shumë, shumë, shumë. Edhe babën e kom pasë pjesëmarrës në të gjitha, domethonë s'ka hezitu asnihere. Kështu që, ai thoshte, "Rrini ju", po ne s'rrishim asniherë.

Anita Susuri: Vitin '98 e përmendëm këtë demonstratën me bukë që ka qenë edhe kem t'u folë për qata, po ndërkohë...

Igballe Rexha Jashari: U lidh me, po, po, po.

Anita Susuri: Atë ditë e di që ka ndodhë ni incident, thashë, ma herët, ni veturë ka hy në...

Igballe Rexha Jashari: Grupin po.

Anita Susuri: Qysh ka qenë qato momente? Ku keni qenë? N'fillim apo?

Igballe Rexha Jashari: Unë kom qenë n'fillim. Ajo ka ndodhë, domethonë...

Anita Susuri: Kah mesi.

Igballe Rexha Jashari: Po, kah mesi. Kur kemi dëgju, domethonë ashtu atëherë gjithë masa pak është trazu që çka po ndodhë, çka po dojnë me ba, domethonë edhe po... për fat t'mirë s'ka qenë, s'ka

ndodhë diçka e keqe, domethonë. Është ngritë ajo gruja, është kthjellë, i kemi, e kemi tërhjekë, domethonë prej rendit po, domethonë s'ka ndodhë diçka ma e keqe. Por, ato kanë qenë të pritshme. Personalisht, po flas për veti, domethonë kanë qenë të pritshme vazhdimisht të gjitha ato të mundshme që të ndodhin n'çdo moment kanë qenë të pritshme. S'ka qenë diçka që ti nuk e pret. Që t'pret plumbi vazhdimisht, domethonë, ajo po nuk je ndalë. (Qeshë)

Anita Susuri: Deri n'cilin vit keni vazhdu me punu te “Bujku”?

Igballe Rexha Jashari: Deri në mbyllje të gazetës “Rilindja” në vitin 2001.

Anita Susuri: 2001. Po gjatë luftës a ka vazhdu?

Igballe Rexha Jashari: Po, po, ka vazhdu tanë kohën.

Anita Susuri: Ju keni qenë këtu?

Igballe Rexha Jashari: Tanë kohën. Kom shku dy here, domethonë, nga dy muj në Tiranë, sepse “Rilindja” botohej në Tiranë, domethonë, n'atë kohë edhe kom shku dy herë nga dy muj në vitin '95 edhe '96 kom shku në Tiranë, domethonë. Ishin atje gazetartë, po unë kom shku në gazetën atëherë që ishte në Tiranë. Por, tanë kohën ka vazhdu “Bujku”, asni ndërprehe s'e ka pasë si gazetë. Ka vazhdu.

Anita Susuri: Domethonë herën e parë kur keni shku në Shqipni...

Igballe Rexha Jashari: Hera parë ka qenë viti '93. Kemi shku delegacioni në mbajtjen e Kuvendit të Parë të Gruas të Shqipërisë. Kom shku unë me Nekibe Kelmendin dhe [Naxhije Buçincën](#). Kemi qenë gratë e para që kemi shku me marrë pjesë në atë kuvend. Ka qenë viti '93 kur mua edhe atyne natyrisht u qitën vula e kufirit dhe, domethonë ma nuk kom lëvizë me pashaportë. Kom lëvizë ilegalisht, domethonë, në vitin '95 dhe '96 kom shku nga Ulqini, domethonë në Tiranë dhe kom ardhë prej asaj pjese se, domethonë ti arrestohesh po ta kishe vulën, domethonë e Shqipërisë, kufirit, domethonë në pashaportë. Edhe për mos me e bo atë rrezikim, domethonë kufiri ka...

Anita Susuri: E kur keni shku në Shqipni a ka qenë ajo që keni pritë? Si e keni pa Shqipërinë?

Igballe Rexha Jashari: Kur... në '93-tën, domethonë, na ka marrë gruja e... po mendoj, jemi vendosë në familjen e Jusuf Gërvallës fillimisht. Mandej jemi nda si delegate, kemi shku nëpër familje tjera se kemi ndejtë disa netë. S'më kujtohet sa, por disa netë. Ndoshta katër netë kemi nejt, domethonë apo pesë në Tiranë. Në familjen e Jusuf Gërvallës që kemi shku aty ka qenë gjithçka okej, domethonë s'e kemi mendu, kur e pamë, domethonë situatën që s'ka me pasë as ushqime as... por jo, domethonë ka qenë edhe frigoriferi i mbushur edhe gjanat, aty okej.

Në familjen n'cilen kom vazhdu që kom fjet, aty nuk kanë qenë kushtet e mira. Ka pasë, domethonë ka qenë m'kujtohet me ciment, domethonë, n'vend t'pallakave ajo shtëpia. Po kështu ato shtetërit petë, domethonë kështu {tregon em duar}. Ni gru shumë e zoja, domethonë që ni familje aty që aty kom bisedu pak ma shumë, domethonë se qysh ata e njohin Kosovën, domethonë. Edhe aty unë mund t'them që ka qenë e njejta. Sikurse në Kosovë ata që kanë qenë t'interesum për Shqipërinë kanë ditë dhe e kanë njoftë ka qenë edhe prej anës tyne.

Ata që kanë qenë edhe ata kanë majtë libra dhe kanë lexu edhe n'iligalitet edhe kanë dëgju, domethonë gjana tjera edhe kanë diskutu sikurse këtu që ata që kanë qenë t'interesum me njoftë Kosovën e kanë njoftë, domethonë edhe ma mirë. Ata që, ka pasë edhe njerëz që prej punëve t'veta, jetës t'vet s'i ka interesu. Po e them, domethonë, tani që në vitin '95 kur kom shku me burrin, domethonë atje e kemi njohur ni mik që e kemi edhe tani, një shkrimtar, ni profesor, domethonë, Bardhosh Gaçe që për mu ka qenë ni befasi. Po e them këtë, poezitë e tij të shkruara kanë qenë sikurse me qenë për vendet e Kosovës, ka qenë sikurse me qenë ai në Kosovë.

Unë jam befasu me përshkrimin e tij për Pejën, për Podujevën, për lumenjtë. Domethonë thu ti ai ka qenë, ai s'kish qenë po ai prej leximeve, domethonë prej atyne që kishte dëgju e kishte ba përshkrimin në poezitë e veta dhe librat e veta. Edhe unë u befasova domethonë ashtu. Që po them në vitin '95, domethonë, ishte hera e parë që shkova në Vlorë bashkë me bashkëshortin se ky miku ishte i Vlorës dhe aty kom përjetu ni diçka si në filma. Në familjet e njohura siç ishte piktori i njohur Skender, s'më kujtohet si ka mbiemrin, po është piktor i njohur, domethonë na çoi te do familje kështu të njohura edhe aty pritja e tyre ishte... vlla, motër prej Kosovës, domethonë ishte ni pritje shumë e përzemërt, shumë shumë. Po jeta ishte në varfëri.

Mu në atë kohë prej vitit '91 daja m'ka jetu, ky daja që ishte i burgosun, domethonë masi e malltretun shumë, domethonë ishte në atë burgun e Leskovcit me grupin e intelektualëve dhe e maltretun shumë edhe, domethonë, natyrisht që ishte i përndjekur. Jetoj ni kohë n'ilegalitet këtu, po vendosi me shku ilegalisht në Shqipëri, dhe ka jetu në Tiranë gjatë gjithë ktyne viteve. Kështu që, unë sa herë kom shku në Tiranë e kisha dajën aty që jetonte. Mori ni banesë dhe për t'gjithë ato njohje, domethonë edhe për pjesën që, edhe daja që ishte aty ishte informu se aty familjet kanë qenë të ndryshme.

Në familjen ku kam ndejtë, domethonë, që kam qëndru, kam banu faktikisht dy muj ishte, ajo ishte ni familje që kishte qenë ushtarak në atë kohë. Ushtarak para dhe i kishte të gjitha, domethonë i kishte të gjitha kushtet. Ai tregonte, domethonë që kanë qenë të ndara kategoritë t'cilat janë, kanë qenë ma mirë me standard. Në kuptimin e pajisjes me mjete se ndoshta, domethonë te pjesa e ushqimit janë ruajtë secili që ta ketë të njejtën, domethonë. Në '93-ten ka qenë skëterrë, domethonë, shumë, shumë.

Daja im tregonte që prej '91-tës deri '93-tën megjithatë ka fillu diçka, po '93-ten ka qenë jeta... po me kohën... mu tash kur i shikova fotografitë e kisha ni fotografi të Orikumit në Vlorë që kemi shku me bo pushimin me atë mikun, asni sen i ndërtun s'ka qenë n'atë pjesë. Po ashtu në vitin '95 në Shëngjin që

kam shku se e kishim ni mik në Lezhë dhe kemi qëndru dy javë në Lezhë edhe shkojshim pushimin në Shëngjin me bo, ka qenë asni ndërtim.

Përveç atyne të ushtrisë që ishin, domethonë ato që i kanë bo pushimet elita ndoshta e Shqipërisë, domethonë përveç asaj ndërtese aty, asni. Domethonë, ky ndryshimi që, t'mos flasim për Durrësin, domethonë, hiç, hiç, hiç. Këtë ndryshim e kom pa, domethonë n'vazhdimësi mandej në Shqipëri me vite, janë ba tani sa, 25 vite, 26 vite.

Pjesa e Katërt

Anita Susuri: Nëse doni edhe diçka me shtu për vitet e '90-ta...

Igballe Rexha Jashari: Po du me thanë te burgosja e motrës sepse, domethonë, ai ka qenë ni moment shumë i randë për familjen faktikisht, domethonë në veçanti. Shtëpia jonë gjatë viteve '90-ta ka qenë ni shtëpi ku s'e di kush nuk ka hy, ka dalë. Domethonë, ka qenë ni lloj punkti i veçantë, domethonë ku njerëzit kanë ardhë shumë, kanë lëvizë shumë është ba aktiviteti prej aty, domethonë shumë. Burgosja e motrës për të gjithë ka qenë shumë e randë, për mu n'veçanti shumë shumë. Se m'kujtohet që i thojsha nanës, "Ti s'ki arsye m'u mërzitë, unë kom ma shumë", domethonë deri n'atë shkallë. Edhe e di atëherë kur e kishin dërgu prej Sekretariatit⁵, domethonë këtu unë kom dalë prej "Rilindjes" edhe n'semafora kom kalu te Pallati Rinisë aty ajo ka qenë n'veturë, domethonë m'ka pa.

Mandej ato gjyget e në burg ishte Nekibja, avokatja vullnetare që erdhi. Kishte motra tre avokat n'atë kohë, por Nekibja tha, domethonë, "Du une vullnetarisht", domethonë, "me qenë, meqë ka qenë në kryesi të LDK-së", domethonë, "dhe ka qenë n'aktivitet. Du vullnetarisht me mbrojtë", "Okej". Edhe unë Nekiben e kisha fqinje, domethonë aty. Me mëngjes kur nuk flejsha e shisha andërr pavarësisht vizitave unë meniherë, "Nekibe, sot e kanë malltretu atë sigurisht edhe duhet t'shkojmë në Lipjan", edhe kemi shku, domethonë.

Asniherë, asniherë s'më ka thanë, "Sot nuk kom kohë", domethonë, përveç avokatëve që ata i kishin oraret e tyre, unë me Nekiben, domethonë kom shku vazhdimisht. Ajo vizitonte se unë s'kisha mundësi, por unë aty me ndejtë me të afër burgut e ajo hynte vizitonte motrën gjatë asaj kohe. Motra është dënu tri vite, domethonë po nuk i ka mbajtë, domethonë ka mbajtë muj se e lshun me kusht mandej, por s'arriten me mbajtë, domethonë gjatë asaj kohe. Kjo, edhe ky ishte ni përjetim shumë, shumë i randë për neve si familje.

Anita Susuri: Si ka vazhdu periudha e luftës për ju? Domethonë '98-ën ka qenë kjo marshi i grave për, me bukë që e kanë bo. Po pastaj ka fillu me u egërsu edhe ma shumë situata, domethonë derisa kanë ardhë bombardimet.

⁵ Sekretariati i Punëve të Brendshme.

Igballe Rexha Jashari: Derisa kanë ardhë bombardimet.

Anita Susuri: Si ka qenë gjithë kjo periudhë...

Igballe Rexha Jashari: Ferr ishte.

Anita Susuri: Për juve?

Igballe Rexha Jashari: Ka qenë ferr. Vërtetë ishte ni ferr i vërtetë, domethonë, gjithë Kosova, vërtetë... edhe ato përpjekjet për organizim, domethonë forma për me mbajtë krejt situatën në kontrollë, domethonë ishte ni... secili që ishim n'aktivitet, domethonë u përpiqeshim që n'forma tona me mbajtë atë, megjithatë jetën te njerëzit, domethonë jetën muj me thonë te njerëzit që do t'bahet edhe do t'bahet ma mirë që lufta ka me përfshi mendojshim, domethonë atë e shishim që do ta përfshijë gjithë Kosovën. Si do t'ndodhë e çka do t'ndodhë ndoshta, domethonë edhe vdekjen e kishim secili afër, domethonë na u duke që vdekjen e kemi shumë afër secili.

Kur kanë ardhë me na qit prej shtëpisë, për herë t'parë, domethonë, po e them këtë që para se, gjatë asaj kohe ishte gruja e Adem Demaçit, domethonë e ndjera tani zonja Xhemajlije që vinte sa herë domethonë edhe m'takonte. Kom shku edhe kom ardhë shumë te ata. Edhe thoshte që, "Ti n'këtë kohë duhet të ndrosh si pamje, duhet t'i ngjyrosësh flokët me ngjyrë tjetër, duhet t'ndrosh si pamje, t'mbulohesh sepse je", domethonë, "sepse je personi që ka me ndodhë me ty diçka".

M'kujtohet që edhe tri ditë para se me na qit prej shpisë, para se me ardhë ata policia, paramilitarët, ushtria. Ajo erdh tha, domethonë, "Ende s'ke ndrru kurgjo?" Domethonë, edhe, "Vazhdon kështu me qenë je shumë keq", thashë, "Po edhe nana ime", thashë, "të gjitha motrave na tha këtë që duhet t'ndrojmë". Ajo që ishte me flokë t'bardha t'ngjyrosë ndryshe, sepse domethonë, t'bahemi tjera për mos me u vrejt prej policisë. Të gjitha në formën e vet ishin, domethonë, të...

Anita Susuri: Të kërkuara.

Igballe Rexha Jashari: Të kërkuara. Motra që ishte në kioskë që thashë, domethonë atë e kanë marrë në polici. Faktikisht, domethonë kur e kanë pa n'rrugë, "Ah, Nazo ti si tu!" [Srb. Ah, Nazë, ti qenke këtu] edhe e kanë marrë e kanë çu n'polici edhe ato kërcnimet, domethonë, "Do ta hekim veshin, dorën, kamën", domethonë, do t'bahmë kështu edhe ajo përveç tjerave. Edhe vllau ishte ma me pjesën, domethonë kjo pjesa e Albinit, Bujar Dugollit sa ishin ata pesë vetë, domethonë në organizimin e kësaj pjese tjetër. Ishim të gjithë me nifare forme në aktivitet.

Kur erdhën me na qit prej shtëpisë, domethonë na radhiten në dhomë te vjehrritë, kunati, kunatat, unë me burrin. Thanë, "Ti dishu", burrit, domethonë, ia futën automatin ktu {bën me dorë kah fyti} edhe veç... ama unë si person, domethonë dojsa me rujtë edhe e disha çka osht' ka ndodhë, unë shisha

çdo ditë edhe që është e mundshme që të ndodhë edhe me neve. Natyrisht që ajo nuk ishte e papritshme, domethonë psikikisht njeriu duhet t'përgatitet për situatat kur vijnë.

Vetëm e shisha, domethonë, që kur do t'ofrohet ky gisht {bën me dorë ka fyti} që plumbi se aty nuk ia heke automatin, domethonë. Edhe ai kur tha, "Dishu", natyrisht që ishte reagim prej burri. Ai {shpjegon me gjeste} ashtu reagoi, ai e shtrijti për toke edhe unë vetëm e pritsha që kjo {kërcen nga ulësja}. E shtrijtën edhe kunatin faktikisht, domethonë, aty. Dhe unë fillova ngadalë ta shpërthejoj rripin, isha me pantolla, domethonë, filloi thashë, "Do me ndodhë ajo që po ndodhë gjithkund do me ndodhë edhe këtu po me u përpjekë me sa ma pak pasoja".

Ky ishte qëllimi që t'mos vritet dikush, t'mos ndodhë, domethonë ma e keqja edhe sa ma pak. Ndodhë, ndodhë, domethonë unë i kisha thanë edhe burrit edhe, domethonë, në kacafytje, "Dije që nëse jom vra, jom vra në kacafytje", s'osht', domethonë problem, "Dije që ajo do t'jetë e fundit". Po për mos me i rreziku edhe tjetër përpjekje që ta ruaje qetësinë, domethonë. Isha shumë e vetëdijshme, domethonë për atë pjesën e mundshme.

Po fati ishte, domethonë që ai edhe nihere ka ardhë, unë fillova t'i deshi pantollat ngadalë, domethonë shumë ngadalë, domethonë edhe me qetësi ashtu pa ndonjë reagim. Vjehri tha, "Grunë e kom smutë prej zemrës edhe do me lshu zemra, ju po boni kështu kësi gjana e kështu". Ai edhe niherë vjehrit iu sul, "Ti mbylle gojën". Edhe niherë ka ardhë m'ka kapë, e kisha ni ashtu {shpjegon me duar} të mbyllun tha, "Zhvishe shpejt", ashtu edhe une, "Okej". Pa anej, domethonë veç pritsha që ata dytë kur po ekzekutohen, domethonë në nifarë forme.

Përneherë ka hy njëri tha, "Për ni sekond jashtë të gjithë". Shpëtum, domethonë të gjithë prej ma t'keqës prapë. Shpëtum të gjithë. Po burri im thoshte që s'du me dalë, vazhdonte që, "S'du me dalë prej shpisë", edhe mu, domethonë, "Ti patriote e madhe s'do t'kthehesh ma kurrë në Kosovë", domethonë, "Sa është kthy baba im në Toplicë atje, familja e babës tim, s'ki m'u kthy kurrë në Kosovë. Ku po don me shku?" Vritu qitu me nifarë forme.

Po kem dalë, domethonë, jemi... me trenin ashtu në Maqedoni. Atje ajo shoqja që e përmenda, domethonë gjinekologia në Strugë, domethonë jetonte kishte shku atje dhe jetonte sepse burrin e kishte të Strugës...

Anita Susuri: M'fal, me çfarë date ka qenë qikjo?

Igballe Rexha Jashari: 1 prill, 1 prilli [1999], po. Kur kemi shku atje atëherë, domethonë, kishin qenë ni ekip m'duket holandez kishin qenë dhe, domethonë kur i tregova kështu kështu gjithë atë që ka ndodhë thotë, domethonë, "Atëherë me bisedu edhe me këta mjektë edhe me pa situatën e krejt" e thojnë, "Jo, mirë je", domethonë, "Je e fortë". Se ato pësimet mendoj që janë, pavarësisht asaj që ke

shpëtu në nifare forme ato pësimet në forma tjera janë, domethonë se janë kujtime shumë t'randë. Janë përjetime t'randë faktikisht.

Anita Susuri: E prej që keni dalë prej shpisë deri...

Igballe Rexha Jashari: Deri në Strugë.

Anita Susuri: Strugë, si ka qenë ai udhëtim?

Igballe Rexha Jashari: Domethonë, treni tmerr. Çdo gja që kom pasë, domethonë të arit i kom dhanë vjehrrës, kunatës, t'gjithë atyne ka diçka që ta mbajnë. I kom hjekë s'paku unë, domethonë t'mos jem viktimë e diçkafit ashtu. Ni pshtjellje me ni shall ashtu {shpjegon me duar} edhe, domethonë n'tren që dolëm në Bllacë, domethonë ni natë kemi nejtë. S'kemi nejtë ma shumë, domethonë ditën tjetër jemi dalë, kemi shku në Gostivar, sepse në pjesën poshtë nuk u lejojke me shku. Domethonë, kemi ndejtë dy netë në Gostivar. Sepse thojshin, "S'ka depërtim ma poshtë se Gostivari, s'mundeni me shku në Strugë".

Se kërkesa ime... jo që aty, njëfsha gratë aktiviste t'cilat kanë qenë, domethonë në Shoqatën e Grusë edhe ato kur m'panë, domethonë, menihere, "O Igballe edhe ti", edhe domethonë, u vendosëm n'familje. Krejt ishte okej. Por ishte synimi im përsëri me shku te ajo shoqja ime, domethonë Flora Doku në Strugë atje dhe pas dy dite kemi shku atje. Atje kemi mbajtë... ajo ishte ni grua që ka qenë aktiviste edhe e dinte, domethonë jemi përpjekë që t'i gjejmë disa gra që ishin aty. Kemi mbajtë takime të ndryshme që si t'ja bajmë, qysh t'ja bajmë që qysh mujmë me ndihmu, domethonë pjesën që ka mbetë në Kosovë. Familja ime komplet ishte në Kosovë, domethonë s'ishte... e vetmja une. Dhe ajo ka qenë ni shkatërrim për mu, domethonë që...

Anita Susuri: A keni pasë kontakt me ta?

Igballe Rexha Jashari: Kemi, shumë pak, domethonë dy javë ditë fare, fare, fare. Pas dy jave, domethonë kur i kom kontakti ishin te tezja sepse telefonin n'shpi, domethonë natyrisht që nuk bojke edhe motra ishte, kishte dalë veç në ilegalitet kjo që ka qenë e burgosun. Po ashtu vllaznit ishin jashtë, kishin shku nëpër fshatra, prindërit ishin te tezja, domethonë këtu në Prishtinë. Dy motra tjera te ni teze tjetër këtu në Ulpianë edhe, domethonë derisa e kuptova që këto lëvizjet kah janë ba atëherë kom vazhdu me thirrë prej postës se natyrisht që familjes nuk majshe me i thanë që me ia kërku telefonin, por dilsha çdo ditë në postë në Ohër ku isha e vendosun. Nuk shkova në Strugë, po në Ohër isha vendosë si familje. Çdo ditë thirrsha pavarësisht, numrat që i ditsha në Prishtinë.

Ka ndodhë shumë herë që m'kujtohet, domethonë ni familje që e kom falënderu mandej në Kodër të Diellit e mësova kush ishte, po vetëm numrin që e disha të Prishtinës e thirrsha, "Çka ka ndodhë në Prishtinë mramë?" Shembull, domethonë, sa me ditë gjendjen e përditshme, çdo natë. Ato aeroplanat

që kalojshin, domethonë nga Ohri i pritsha zgjuar edhe me lot kam qenë vazhdimisht, vazhdimisht. Përjetime shumë të randa t'asaj kohe. Mendoj që ma e randë e kom pasë, domethonë gjatë asaj kohe që kam ndejtë në Ohër që ishte lufta në Kosovë sesa periudha tjetër që vet isha pjesë e asaj. Ajo ishte edhe ma e randë sepse ishin familja, ishin motër e vllazër të cilët ishin ma t'vegjël se unë të gjithë, domethonë, ma t'ri se unë. Nuk kom mendu asnjëherë që të gjithë do t'shpëtojnë, asniherë.

Atë natë kur kanë hy, domethonë forcat edhe une jam nisë prej Ohrit me ni tjetër kënd, jo familja e burrit, domethonë komplet ishin atje. Po unë thashë, "Sante nëse...", në Tetovë ishte ni grup i gazetarëve, domethonë kom shku jom taku me atë grupin e gazetarëve në Tetovë edhe kom vazhdu rrugën për Prishtinë. Kur kom ardhë, kom mbërri natën i kom zgju prej gjumit, domethonë. Ata m'imitojnë, "A është e mundur", thojsha, "të gjithë jeni me kamë, durë", domethonë, "të gjallë", antarët e mi t'familjes. Ishte shumë përjetim i randë. Muj me thanë ma i randë sesa vet jeta.

Anita Susuri: Qyteti qysh ka qenë?

Igballe Rexha Jashari: Qyteti, vetëm tash i them burrit, domethonë, i kom dy bli n'oborr, domethonë tani, domethonë, thashë, ai, "Po i hekim?" Thashë, "Ajo aroma e blinjve te Radio Prishtina m'kujtohet atë ditë kur kom ardhë", thashë, "o Zot", se qyteti, qyteti ka qenë tmerrësisht i zi ende. I zi, i zi sepse sa e kishin përjetu atë natën e randë, domethonë kur kanë dalë ushtria ruse edhe ato kërcënimet, domethonë edhe sa e kishin përjetu ata.

Motra ime kishte thirrë, domethonë, atë ditë. Unë paskam ardhë ndoshta 14 [qershor] ka qenë, 12, 14 ndoshta, motra ime atë ditë... atë natë që ka ndodhë qato drita, domethonë edhe qajo rreziku që ka qenë i gjithë Prishtinës. Motra ime m'thirri prej postës, qajo që ka qenë nëpër ilegalitet. Thashë, "Si po guxon me dalë?" Thashë, "Se po thonë që ka", tha, "Jo, jo s'ka ma rrezik". Po atë natë kishin qenë vërtetë n'rrezik, shumë rrezik.

Ata m'tregojshin që janë taku për fat t'mirë me disa çka kanë mujtë me qenë ekipe, por që anglez kanë qenë, domethonë edhe holandez. Motra ka qenë profesoreshë e gjuhës angleze tjetra, domethonë edhe vllau po ashtu që ishin taku edhe kishin bisedu edhe ju kanë thanë që, domethonë, "Sante duhet t'bani kujdes", domethonë, "të gjithë si familje. Mos dilni sepse kanë me, lëvizjet e ushtrisë kanë me qenë n'këtë anë, nëpër Prishtinë". E di që atë natë kishte qenë, por ka përfundu mirë për familjen time, domethonë, n'fakt.

Anita Susuri: E në shpinë e ju a ka pasë dëmtime, a si jeni rimëkëmbë?

Igballe Rexha Jashari: Po, ka pasë dëmtime, domethonë janë marrë, janë marrë gjana. Ka pasë dëmtime të kulmit me plumba, sepse aty ka qenë ai punkti i paramilitarëve jo larg shtëpisë te... faktikisht edhe dëmtimi i tjegullave, i dritareve. Këto kanë qenë, por dalë ngadalë. Meqë u kthym, domethonë bashkëshorti vazhdoi me punu në KEK ku ka punu, domethonë aty nuk i ka humb vendi i

punës. Po ashtu kishin depo t'pijeve edhe para luftës, domethonë me ato ishin marrë po, domethonë rimëkëmbja filloi edhe n'atë formë, domethonë, që kanë vazhdu me atë depon që ishin edhe kështu. Në familjen time te nana pothuajse të gjithë u aktivizun në organizata joqeveritare, domethonë vllazën e motra. Fillun punë me OSBE, me, domethonë, me UNDP, me t'gjitha këto organizata. Fillun domethonë stabilizimin edhe u punësun.

Faktikisht mas luftës ishin ende të burgosur dhe motra ime kryetare e Shoqatës të Burgosurve edhe kanë vazhdu demonstratat, kanë vazhdu protestat edhe kemi qenë ballë tyne vazhdimisht edhe n'organizim vazhdimisht. Meqë ishte motra, domethonë ishim edhe ne aty. Ajo ishte organizatore e protestave t'mdhaja për lirim e të burgosurve politik, domethonë që me Kouchner ishte në Këshill Tranzitor n'atë kohë, ishte anëtare e Këshillit Tranzitor. Me atë ka vazhdu edhe ajo pjesë deri n'lirimin e të burgosurve edhe pas lufte.

Une kam vazhdu punën n'gazetë, domethonë gjatë asaj kohe deri n'mbyllje. Mbyllja ishte shumë e dhimbshme. Edhe atëherë kur filloi qikjo, domethonë që do të mbyllet, s'do të mbyllet "Rilindja", unë përgatita ni libër, po mendoj librin e Sevdije Ahmetit, librin "Kurrë më". M'ftoi ajo që t'përgatis atë libër edhe fillova bashkëpunimin me organizatën joqeveritare Qendra për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve, ku ishin Vjosa Dobruna dhe Sevdije Ahmeti, themeluese të asaj organizate.

Me mbylljen e "Rilindjes", domethonë unë vazhdojsha me punu edhe për gazeta tjera edhe për "Teutën" mandej "Kosovarja" që ishte mandej "Teutën" edhe për gazeta tjera periodike. E pata ni ftesë edhe për, domethonë gazetatat e reja që dolën, domethonë t'jem aty, por nuk kom shku, domethonë. Meqë, domethonë gazetatat u bonë pjesë të rrymave të ndryshme politike, nuk kom dashur t'jem po kom vazhdu t'shkruj për "Teutën" kom shkru, domethonë, disa shkrime edhe ma vonë.

Anita Susuri: Aktivitetin politik, domethonë, nuk e keni vazhdu mo?

Igbal Rexha Jashari: Nuk e kom vazhdu në Lidhjen Demokratike. Pas punësimit tim në ministri, domethonë kom shku në Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës me shumë insistim të njerëzve se, domethonë se unë nuk kom dashur se isha pjesë e organizatës joqeveritare, pesë vite isha, domethonë, aty. Po ashtu jom themeluese e Koalicionit të Grave të Kosovës që përbëhej prej subjekteve politike, shoqërisë civile dhe prej mediave. Domethonë, ishte Koalicioni i Grave n'atë kohë.

Ishim ni grup i grave që u bom trajnere të *Women Can Do It* [Gratë mund të ia dalin], ishim shtatë gra t'cilat ishin pjesë, domethonë, e atij Koalicionit të Grave të Kosovës. Ishte organizata që unë e kom pasë deri vonë, domethonë tani s'di, katër-pesë vite janë që nuk është më aktive edhe pse çdo ditë menoj me aktivizu, ri-aktivizu. Po, atëherë isha pjesë e aleancës, domethonë isha këshilltare në Kuvendin Komunal të Prishtinës, domethonë, ni mandat, kështu.

Anita Susuri: E vitin 2008 kur ka ndodhë pavarësia, si e keni pritë?

Igballe Rexha Jashari: Ishte, ajo ishte ni, domethonë, ni realizim i t'gjithë asaj që ti e ke mëtu e që e ke kërku e që e ke dashtë. Ishte, domethonë, ni, që ende duhet, domethonë...

Anita Susuri: Qysh ka qenë ajo ditë për juve? Keni qenë n'shpi apo keni dalë?

Igballe Rexha Jashari: Kom dalë, po, po, patjetër kom dalë atë ditë. Patjetër kom dalë me edhe me përjetu kom dalë qitu n'shesh, domethonë edhe ka qenë gëzim shumë i madh, gëzim shumë i madh.

Anita Susuri: Kisha dashtë edhe tash me ditë me çka mirreni? Si e kaloni kohën?

Igballe Rexha Jashari: Unë, domethonë, prej vitit 2005, konkurova në ministri isha ende domethonë në organizatën joqeveritare Qendra për Mbrojtjen e Nënave dhe Fëmijëve. Kom pasë krysisht, domethonë e kom udhëheq informimin në atë pjesë, i kom bo buletin e organizatës edhe të gjitha raportet, domethonë informative të organizatës. Ishte fati im, ishte pjesa ime që ushtrija edhe aty edhe pse ka pasë raste që edhe me rastet jam marrë, domethonë raste të ndryshme të dhunës, të prostitucionit, të drogës, të ndryshme.

Ndoshta ishte ni shkas shumë i madh, domethonë ni punëtori që e patëm n'qendër edhe në *retreat* [Eng. tërheqje për planifikim] edhe ishim. Edhe mu, e ndjera, Sevdije Ahmeti, drejtoresha tha, "Ti duhesh ti lexosh disa letra të grave të dhunuara", sepse qendra mirrej me ato gra. Ato gra i vendosi nëpër shtete të ndryshme, komunikimi ishte i vazhdueshëm. Ato, domethonë, edhe, thotë, "Duhesh m'i lexu".

Kom ndejtë e di, domethonë që shumë pa gjumë ato tri netë që ishin në atë *retreat*. E kam lexu letrat e atyre grave të dhunuara, domethonë që për mu ishte ndoshta arsyeja më e fortë që unë ta lo krejt organizatën joqeveritare, aq përjetim i madh ishte. Përveç krejt rasteve tjera që kishim, domethonë ai ishte përjetim shumë i madh.

Ishte ni konkurs në Ministrinë e Tregtisë n'atë kohë pranoheshin, ishte viti 2005 pak ma pak njerëz ka pasë që kanë konkuru ashtu. Edhe unë thashë po kaloj në pjesën që e kom kry ekonominë, domethonë edhe po du me provu edhe këtë pjesë. Nëse pranohem aty do t'jem aty dhe e lëshoj organizatën. I tregova, domethonë Sevdijes dhe konkurova aty. Ishte vllau ai që m'tha, domethonë, "Edhe aty duhet ma si ekonomiste ta jepësh kontributin se mjaft, kryje edhe këtë pjesë". Thashë, "Okej".

Pranova edhe pse paga ishte nja pesë fish më e ultë se në organizatën joqeveritare ku e kisha. M'kujtohet që baba imi i ndjeri kur atë natë që kisha fillu punën edhe shkova dhe nana i thotë, "Uroja", domethonë, "nesër ka me shku me punu n'vandin e ri t'punës n'ministri", tha, "Nuk ma ka tregu arsyen

që po e lshon ni vend pune me pagë kaq t'madhe dhe po shkon me ni vend t'punës. S'ma ka tregu arsyen”.

Jo që po them, po baba shumë, shumë, tepër, tepër m'ka dashtë, domethonë, thoshte, “Sa gjashtë fëmi tjerë edhe këtë”, se mbas shtatë vitesh edhe kam qenë shumë e lidhur me të. Thashë, “Jo, nuk kom ndonji arsye”. Domethonë, se ka mendu a kam pasë presione prej dikujt që une me lshu. Thashë, “Jo nuk kom pasë ndonjë presion”, domethonë, “prej askujt për me lshu vendin e punës. Por”, domethonë, “më është bo mjaft”.

M'dukej që n'secilin lokal që hyja vajzat keqtrajtoheshin, domethonë prej asaj që shihsha mrena ashtu. Domethonë, krijova ni përshtypje që, domethonë është pozita shumë e keqe e vajzave, domethonë tona. Edhe e pashë që ma merrte energjinë, gjithë energjinë ma merrte, domethonë, puna ma merrte shumë energjinë, domethonë, harxhonte sepse e ndjejsa punën edhe fillova n'ministri për mos me mbetë, domethonë.

E kisha organizatën Koalicioni i Grave të Kosovës, plus vazhdova me trajnimet. Domethonë kam qenë edhe monitoruese e zgjedhjeve prej OSBE-së edhe prej Këshillit për të Drejtat e Njeriut po ashtu. Vazhdova me aktivitetet në shoqëri civile, po duke mendu që në ministri nuk kam me ndejtë shumë. Tani vazhdoj me qenë në ministri, udhëheqëse për zhvillim të politikave industriale edhe vazhdoj me ba punën e ekonomistit.

Anita Susuri: Zonja Igballe edhe diçka nëse keni për fund me shtu, nëse doni me përmend diçka që keni harru diçka me pytë ose s'kemi pytë?

Igballe Rexha Jashari: S'kom diçka, domethonë, ishte e veçantë ardhja e djalit tim në jetë, domethonë edhe kjo ishte ni përjetim i mirë, shumë i mirë prej gjithë kësaj edhe që, domethonë, më mban shumë edhe që ai përkushtimi im ajo energjia ime ka shku mandej edhe në atë pjesë edhe kështu.

Anita Susuri: Faleminderit shumë.

Igballe Rexha Jashari: Faleminderit juve.